

Dr. Abdurrahman Çetin

**BAZAT E LEXIMIT TË KUR'ANIT
- *TEXHVIDI* -**

Nga turqishtja:
Rejhan Neziri

Kreuzlingen, 2017

Autor:

Dr. Abdurrahman Çetin

Titulli origjinal:

Kur'an Okuma Esasları - Tecvid

Nga turqishtja:

Rejhan Neziri

Boton:

Bashkësia Islame Shqiptare "Hëna e Re"

Romanshornerstr. 16

CH - 8280 Kreuzlingen

www.el-hikmeh.net

Parathënie

Falënderimet i takojnë All-llahut xh. sh., Krijuesit të gjithësisë, Shpallësit të Kur'anit fisnik, që është udhëzim për mbarë njerëzimin e për mbarë kohërat! Përshëndetjet dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Muhammedin s.a.v.s., mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ndjekësit e rrugës së tij!

Duke u nisur nga nevoja që ndjehet këtu në Perëndim për një *texhvid* të thuktë e të qartë si për *mual-limët* (mësuesit fetarë) ashtu edhe për *talebet e mektebit* (nxënësit e shkollave/kurseve fetare), vendosëm ta përkthejmë këtë libërth nga gjuha turke, autori i të cilit është një profesor i imi në Bursa të Turqisë, duke bërë disa reduktime të mjaftueshme të librit origjinal, i cili është vërtet një vepër shkencore, pasi është përgatitur për studentë të fakulteteve teologjike. Aty-këtu kemi bërë edhe përshtatjet dhe thjeshtëzimet e duhura, me shpresën që autori të mos na zemërohet.

Na mban shpresa se ky libërth do ta gjejë lexuesin e vet.

Zoti qoftë i kënaqur me ne, me punët dhe sjelljet tona.

Suksesi vjen prej Tij, falë i qofshim!

Përkthyesi

Përbajtja:

Parathënje.....	3
HYRJE	7
RREGULLAT E TENVINIT DHE TË NUNIT SAKIN	8
1. <i>IDH'HAR-i</i>	9
2. <i>IDGAM-i</i>	10
3. <i>IKLAB-i</i>	12
4. <i>IHFA-ja</i>	13
RREGULLAT E MIMIT SAKIN	14
RREGULLAT E SHKRONJËS R (RA)	15
KALKALEJA	18
PËREMRI PRONOR “Hu” - DAMIRI	20
MEDDI DHE RREGULLAT E TIJ.....	22
A) <i>MEDDI TABI'IJ</i> (ZGJATJA E NATYRSHME)	24
B) <i>MEDDI MUTTASIL</i> (ZGJATJA E NGJITUR).....	25
C) <i>MEDDI MUNFASIL</i> (ZGJATJA E NDARË)	26
Ç) <i>MEDDI LAZIM</i> (ZGJATJA E DOMOSDOSHME)	27
D) <i>MEDDI ARID</i> (ZGJATJA JO E PËRHERSHME)	29
DH) <i>MEDDI LIIN</i> (ZGJATJA E BUTË)	31
IDGAMI DHE RREGULLAT E TIJ.....	33
1. <i>IDGAMI MITHLEJN</i>	36
2. <i>IDGAMI MUTEXHANISEJN</i>	37
3. <i>IDGAMI MUTEKARIBEJN</i>	38
LAMUT-TA'RIFI DHE RREGULLAT E TIJ.....	39
A) <i>IDGAMI SHEMSIJJE</i>	39
B) <i>IDH'HARI KAMERIJJE</i>	40
SEKTEJA DHE HA-I SEKTEJA	41
A) <i>SEKTEJA</i>	41
B) <i>HA-I SEKTEJA</i>	42
SHQIPTIMI I FJALËS “ALL-LLAH”	43
SEXHDE-I TILAVETI.....	44
NDALJA DHE NISJA - VAKF VE IBTIDA	46
GABIMET GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT FISNIK	54
SJELLJET GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT	56
Indeksi i termeve	58

HYRJE

Definicioni i texhvidit

Fjala texhvid nga aspekti etimologjik do të thotë: një gjë ta bësh bukur dhe mirë, ta stolisësh e ta zbuluosh.

Ndërkaq nga aspekti terminologjik do të thotë:

الْتَّجْوِيدُ عِلْمٌ يُبَحِّثُ فِيهِ عَنْ مَحَارِفِ الْخُرُوفِ وَ صِفَاتِهَا .

"Texhvidi është një shkencë e cila merret me shqiptimin e shkronjave dhe me cilësitë e tyre".

Më fjalë të tjera, texhvidi është një shkencë e cila na mëson leximin, shqiptimin dhe artikulimin e drejtë dhe të bukur të Kur'anit ashtu siç i ka hije leximit të Fjalës së All-llahut xh.sh.

Lënda e kësaj shkencë janë shkronjat e Kur'anit fisnik dhe cilësitë, tiparet e tyre.

Vlera e texhvidit

Kur'ani fisnik Muhammedit a.s. i ka zbritur nga All-llahu xh.sh. përmes Xhebrailit a.s., i cili ia ka shpallur Pejgamberit a.s. duke ia lexuar me texhvid. Edhe ai pastaj ia ka përcjellë ummetit të tij me texhvid.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

وَرَتَّلَ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا ...

"... dhe Kur'anin shqiptoje qartë e me kujdes!" (Muzzemmil 73:4)

Mësimi dhe nxënia e shkencës së texhvidit për muslimanët është obligim personal dhe kolektiv. Mësimi i shkencës së texhvidit aq sa të mund t'u ikësh gabimeve të hapura (اللَّهُنَّ الْجُلُүُ) është obligim personal, kurse t'u ikësh gabimeve të fshehura është obligim kolektiv, pra jo për secilin musliman veç e veç, por vetëm për disa që kanë mundësi.¹

Texhvidi ka anën e tij teorike dhe atë praktike. Pjesën teorike njeriu e mëson nga tekstet sikurse ky libri ynë, ndërkaq pjesën praktike duhet mësuar nga personi kompetent për këtë, në radhë të parë nga imami i xhamisë.

¹ Më tepër për gabimet gjatë leximit të Kur'anit shiko f. 54.

RREGULLAT E TENVINIT DHE TË NUNIT SAKIN

(أَحْكَامُ النُّونِ السَّاكِنَةَ وَ التَّنْوِينِ)

Tenvini (التَّنْوِينُ) është **n**-ja e tepërt dhe me *sukun* e cila vjen në fund të emrave të pashquar të gjuhës arabe dhe e cila shkruhet e shqiptohet kështu (ئ = en, ئ = in, ئ = un). Për shembull:


غَفُورٌ (جَنَّاتٍ) جَنَّاتٍ (غَفُورٌ) عَلِيًّا (عَلِيَّمَ) عَلِيَّمَ (عَلِيًّا)

Në rast të vazhdimit të leximit edhe *tenvini* lexohet ashtu siç është, kurse në rast të ndalimit në fund të emrit që bart këtë, *tenvini* nuk lexohet. P.sh. :

مِنْ خَالِقٍ = مِنْ خَالِقٍ غَفُورٌ = غَفُورٌ عَلِيًّا = عَلِيًّا

Nuni Sakin (الْنُّونُ السَّاكِنَةُ) quhet shkronja **n** (nun) kur ajo nuk bart asnje zanore, porse është me *sukun* (ـ). P.sh.: مَنْ يَعْمَلْ ؟ . أَنْعَمْتَ .

Nuni sakın mund të vijë në mes ose në fund të çdo fjale, pra, jo vetëm tek emrat.



Tenvini dhe *nuni sakın*, varësisht sipas shkronjave që vijnë pas tyre, lexohen në njëren prej këtyre mënyrave:

1. *Idh'har* (الْإِظْهَارُ)
2. *Idgam* (الْإِدْغَامُ)
3. *Iklab* (الْإِقْلَابُ)
4. *Ihfa'* (الْإِخْفَاءُ)

Në vazhdim do t'i sqarojmë më hollësisht këto.

1. IDH'HAR-i (الْإِظْهَارُ)

Idh'har do tē thotë: tē lexosh qartë, tē nxjerrësh nē shesh diċka.

Këtu *tenvini* dhe *nuni sakin* lexohen qartë e hapur pa mos u shkrirë ose pa mos u lexuar ndér hundë. Pra, pas leximit normal tē *tenvinit* e tē *nunit sakin* kalohet nē shkronjën vijuese.

Idh'hari bëhet kur pas *tenvinit* ose *nunit sakin* vjen njëra prej 6 shkronjave tē *idh'harit*. Ato janë: (ه غ ع خ ح ئ او س) .

ه غ ع خ ح ئ او س + ن ، ڻ ، ڻ ، ڻ

Për shembull:

سَلَامٌ عَلَيْكُمْ	عَلِيهِمْ حَبْرٌ	عَلِيهِمَا حَكِيمًا	مَنْ آمَنَ
إِنْ هُوَ	عَفْوًا غَفُورًا		

Duhet pasur kujdes që gjatë *idh'harit* tē mos kalojmë nē *sekte**.

* Sekte eshtë ndërprerja e zërit gjatë leximit pa mos marrë frysma.

2. *IDGAM-i* (الْإِدْغَامُ)

Idgam do të thotë shkrirje ose ngjitje e një shkronje në një tjetër.

Idgami ndahet më dysh: *idgam mea'l-gunneh* dhe *idgam bila gunneh*.

A. *Idgam mea'l-gunneh* (الْإِدْغَامُ مَعَ الْفُتْحَةِ)

Idgam mea'l-gunneh bëhet kur pas *tenvinit* ose *nunit sakin* vjen njëra prej këtyre 4 shkronjave: (م ن و ى).

م ن و ى + م ن و ى

Për shembull::

مِنْ يَعْمَلُ عَذَابٌ مُّقِيمٌ عِظَامًا نَّخْرَةٌ مِنْ وَالِ

Te të gjitha këto raste *nuni sakin* ose *tenvini* bashkohen me 4 shkronjat vijuese dhe lexohen ***ndër hundë***, pa mos i lexuar qartë po edhe pa mos i shkrirë tërësisht në shkronjat vijuese.

Këtu përjashtim bëjnë rastet kur brenda një fjale të vetme vjen *nuni sakin* para shkronjës *v* (و) ose *j* (ى). Këtu nuk kemi *idgam*, porse *idh'har*.

Për shembull:

الْدُّنْيَا بُنْيَانٌ قِنْوَانٌ صِنْوَانٌ

Po kështu edhe te:

نَ وَالْقَمَرِ وَمَا يَسْطُرُونَ يُسَنْ . وَالْقُرْآنِ الْحَكِيمِ

Kohëzgjatja: *Idgami mea'l-gunneh* zgjatet sa ***një elif e gjysmë***, respektivisht sa zgjat leximi i tre vokaleve. Një elif nënkupton në texhid kohëzgjatjen e leximit të dyfishtë të të njëjtës shkronjë a vokal, p.sh. aa, ee, ss etj.

B. *Idgam bila gunneh* (إلا دعأْم بلا عنّة)

Idgami bila gunneh bëhet atëherë kur pas *tenvinit* apo *nunit sakin* vjen njëra prej shkronjave *l* (ل) ose *r* (ر).

ل + ن ، م ، س ، م

Shembuj:

هُدَىٰ لِلْمُتَّقِينَ = هُدَىٰ لِلْمُتَّقِينَ مِنْ لَدُنْكَ = مِنْ لَدُنْكَ

مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ = مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ مِنْ رَحْمَمْ = مِنْ رَحْمَمْ

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, te *idgami bila gunneh* kemi një shkrirje të plotë të *tenvinit* apo *nunit sakin* në shkronjën *l* ose *r* dhe këto dyja lexohen me teshdid, të dyfishuara.

Idgami bila gunneh bëhet te dy fjalë të ndryshme, e jo në një.

Idgami bila gunneh nuk zgjatet, por lexohet shkurtë.

3. IKLAB-i (الْأَقْلَابُ)

Iklabi bëhet kur pas *tenvinit* ose *nunit sakin* vjen shkronja *b* (ب).

ب + ن ، ئ ، ئ ، ئ

Fillimisht *tenvini* ose *nuni sakin* shndërrohen në *m*. Pastaj, kjo *m* fshihet duke e lexuar me *gunneh* (ndër hundë), e vetëm pastaj kalojmë në shkronjën *b*.

Shembuj:

سَمِيعٌ بَصِيرٌ = سَمِيعُمْ بَصِيرُمْ صُمْ بُكْمُ = صُمُمْ بُكْمُ

لَيْبَدَنْ = لَيْمَدَنْ مِنْ بَعْدِ = مِمْ بَعْدِ

Vendimi për *iklabin*: bërja e *iklabit* është **vaxhib**, sepse të gjithë imamët e leximit të Kur'anit kanë qenë të një mendimi sa i përket leximit të *tenvinit* ose *nunit sakin* me *iklab* kur këto vijnë para shkronjës *b*.

Kohëzgjatja e *iklabit* është sa një elif e gjysmë, respektivisht sa zgjat leximi i tre vokaleve.

4. IHFA-ja (الْإِحْفَاءُ)

Ihfa do të thotë: të fshehësh diçka, kurse si term i texhvidit përkufizohet kështu:

"Ihfa-ja është një mënyrë leximi midis idh'harit dhe idgamit, larg teshdidit duke e ruajtur gunnen".

Tek *ihfa-ja* nuk kemi *idgam* dhe *idh'har*, pra *tenvini* dhe *nuni sakin* nuk do të shkrihen në ndonjëren prej shkronjave të *ihfasë* që vijnë pas tyre e as nuk do të lexohen qartë e hapur sikur te *idh'hari*. Këtu nuk kemi as edhe *teshdid*. Mirëpo, këtu do të ruhet e shqiptohet *gunneja* (pra leximi ndër hundë).

Ihfa-ja paraqitet kur pas *tenvinit* ose *nunit sakin* vjen njëra prej 15 shkronjave të *ihfasë*. Ato janë: (ت ث ج د ذ ز س ش ص ض ط ظ ف ق ك)

ت ث ج د ذ ز س ش ص ض ط ظ ف ق ك + ن ، م ، ڻ ، ڻ ، ڻ

Nga një shembull për secilën shkronjë:

لَنْ تَنَالُوا	مَاءٌ ثَجَاجًا	وَ كَأْسًا دِهَاقًا	مَنْ ذَا الَّذِي أَنْزَلَ
إِنْسَانِيَّةٌ	مَنْ شَكَرَ	يُنْجِي	أَنْفُسَكُمْ
مَنْ كَانَ	مَنْصُورًا	قِطَارًا	أَنْظُرُوا
وَ فَتْحٌ قَرِيبٌ	مَنْ ضَلَّ		

Shqiptimi: Gjatë shqiptimit të *ihfasë*, majën dhe mesin e gjuhës nuk e ngjesim për qiellzën e gojës por e lëmë të lirë, kurse zërin e nxjerrim edhe nga goja edhe nga hunda.

Vendimi për *Ihfanë*: *Ihfa-ja* është **vaxhib (e domosdoshme)**, pra të gjithë imamët e leximit të Kur'anit janë të një mendimi se *ihfa-ja* duhet të shqiptohet sa herë që pas *tenvinit* ose *nunit sakin* të vijë njëra prej 15 shkronjave të *ihfasë*.


Kohëzgjatja e *ihfasë*: *Ihfaja* zgjatet sa një elif, respektivisht sa zgjat leximi i dy shkronjave.

RREGULLAT E MIMIT SAKIN (مُ)

(أَحْكَامُ الْمِيمِ السَاكِنَةِ)

Shkronja *m* e pavokalizuar (pra me sukun, مُ), varësisht prej shkronjës që vjen pas saj, lexohet në njërën nga këto tri mënyra:

1. Ihfa' (الإِحْفَاءُ): kur pas *mimit sakin* vjen shkronja *b* e vokalizuar:



Kjo zgjatet sa një vokal e gjysmë. Shembuj:

تَعْرِفُهُمْ بِسِيمَاهُمْ يَعْتَصِمُ بِاللَّهِ تَرْمِيْهُمْ بِحِجَارَةٍ

2. Idgam (الإِدْغَامُ) : kur pas *mimit sakin* (مُ) vjen një *mim* i vokalizuar.



Edhe ky idgam lexohet duke e zgjatur sa një vokal e gjysmë. Shembuj:

عَلَيْهِمْ مُؤْصَدَةٌ = عَلَيْهِمْ مُؤْصَدَةٌ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ = فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ

3. Idh'har (الإِظْهَارُ): Është *idh'hari* që bëhet kur pas *mimit sakin* (مُ) vjen çfarëdo një shkronjë përveç shkronjave *b* (ب) dhe *m* (م). P. sh. :

لَكُمْ دِينُكُمْ وَ لِيَ دِينِ الْحَمْدُ لِلَّهِ هُمْ رَاكِعُونَ هُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتٌ

Kjo lexohet qartë dhe hapur pa ndonjë shkrirje dhe pa u zgjatur.

RREGULLAT E SHKRONJËS R (RA)

(أَحْكَامُ الرَّاءِ)

Shkronja *R* (ر) në gjuhën arabe ka një veti krejt tjetër prej shkronjave të tjera. Ajo në disa raste lexohet hollë, në disa trashë e në disa të tjera edhe hollë edhe trashë.

A) Rastet kur shkronja R duhet lexuar trashë* :

1. Kur shkronja *R* bart vokalin *e* ose *u*, (رَ اَوْ رُ). P. sh.:

إِلَيْ رَبِّكَ رُؤْبَاكَ فُرْطًا رَحِيمٌ تَصْبِرُ

2. Kur shkronja *R* është me sukun, ndërsa shkronja para saj ka *e* ose *u*, (رَ - -)

P. sh.: يُرْضُونَكُمْ تَرْمِيهِمْ

3. Kur shkronja *R* është me sukun, shkronja para saj gjithashtu me sukun, kurse shkronja para këtyre me vokalin *e* ose *u*, (رَ - - - -). P. sh.:

لَفِي حُسْنٍ الَّذِي بِالصَّابَرِ

4. Kur shkronja *R* është me sukun dhe para saj ka një kesrah (-) të përkohshme. Pra, kur shkronja *R* është me sukun, para saj ndodhet hemzeja lindhëse (۱), kurse para kësaj ndodhet shkronja me kesrah të përkohshme, atëherë shkronja *R* lexohet trashë, (رَۑ - -). P. sh. :

أَمْ أَرْتَابُوا لِمَنِ ارْتَضَى إِنْ ارْتَبَتْمُ ارْجِعِي

5. Kur shkronja *R* është me sukun, shkronja para saj me vokalin *i*, kurse shkronja pas saj është një prej shtatë shkronjave të *isti'lasë* dhe me vokalin *e*, Shkronjat e *isti'lasë* janë: (ئَرْ - + خ ص ض ط ظ غ ق) . P. sh.:

قِرْطَاسٍ إِرْصَادًا مِرْصَادًا فِرْقَةً لِبَالْمِرْصَادِ

* Kur shkronja *r* ka vokalin *e*, nuk lexohet *re*, por *ra*. Përjashtim bën fjala (Hud: 41), ku *r*-ja lexohet hollë (mexhreeha) e jo trashë (mexhraaha). Kjo quhet *imaleh*.

B) Rastet kur shkronja R duhet lexuar hollë:

1. Kur shkronja R është me vokalin *i*, (رِ). P. sh. : **بُيُّونُ رِزْقًا**
2. Kur shkronja R është me sukun, kurse shkronja para saj bart vokalin *i*, (رِ -).
P. sh. : **الْفِرْدَوْسُ مِنْ فَقًا يَغْفِرُ لَكُمْ وَاصْبِرْ**
3. Kur shkronja R është me sukun, shkronja para saj gjithashtu me sukun, kurse shkronja para këtyre bart vokalin *i*, (رِ - -). P. sh.:
الذِكْرُ الْسِّخْرُ الْقَدِيرُ بَصِيرْ
4. Kur shkronja R është me sukun dhe para saj gjendet shkronja J dhe para saj shkronja bart vokalin E (يِ زِ). P. sh. :
الْطَّيْرُ حَيْرٌ

C) Rastet kur shkronja R në të njëjtën kohë mund të lexohet edhe trashë edhe hollë:

Ka tri raste kur shkronja R mund të lexohet edhe trashë edhe hollë, dhe lexuesi mund të zgjedhë se në cilën mënyrë do ta lexojë:

1. Kur shkronja R është me sukun, para saj gjendet shkronja S (ص) ose T (ط) po ashtu me sukun dhe para tyre gjendet një shkronjë me vokalin I, (زِ / صُ / طِ).
P. sh. : **مِنْ عَيْنَ الْقِطْرِ**

2. Kur shkronja R për shkak të pozitës për t'u ndalur që ka mund të lexohet trashë, kurse për shkak të bazës së saj mund të lexohet hollë. P. sh. :

إِذَا بَسَرْ فَاسِرْ أَنْ أَسْرِ

Sqarim:

- a. Në rastet e mësipërme, meqë shkronja R është pa vokal, shkronja para saj gjithashtu pa vokal, kurse shkronja para këtyre ka vokalin *E* – sipas kësaj pozite që ka – shkronja *R* mund të lexohet trashë.
 - b. Baza e këtyre fjalëve është: **إِذَا يَسْرِي أَنْ أَسْرِي فَاسْرِي**, mirëpo shkronja e fundit (ي) është e fshehur. Prandaj, për të dhënë shenjë në këtë (ي) origjinale, shkronja *R* mund të lexohet hollë.
3. Kur shkronja *R* nuk ka vokal, shkronja para saj ka vokalin *i*, kurse shkronja pas saj ka vokalin *i* dhe është një prej shkronjave të *isti'lasë*, atëherë shkronja *r* mund të lexohet edhe trashë edhe hollë, (ڙ, ڙ). P. sh.: **ڪُلُّ فِرْقٌ**.

Ç) Rregullat lidhur me shkronjën *R* të përforcuar (ڙ)

Në qoftë se në një fjalë të vetme ndodhet shkronja e përforcuar *RR* (ڙ), atëherë *R*-ja e parë lexohet sipas pozitës që ka *R*-ja e dytë. Nëse e dyta duhet të lexohet trashë, atëherë edhe e para lexohet trashë, nëse ajo duhet të lexohet hollë, edhe e para lexohet hollë. P. sh. :

1. **ڦڻ** - lexohet trashë, ngase *R*-ja e dytë bart vokalin *u*. Baza e saj është - **ڦڻڻ**.
2. **ڙڙ** - lexohet hollë, ngase *R*-ja e dytë bart vokalin *i*. Baza e saj është - **ڙڙڙ**.

KALKALEJA (الْقَلْقَلَةُ)

Kalkale do të thotë *dridhje, tronditje, venie në lëvizje*.

Kurse në texhvid do të thotë: “*Dridhje e vendformimit në mënyrë të dëgjueshme sa të dëgjohet një tingull i forte*”.

Rregullat e *kalkales*:

1. *Kalkaleja* bëhet kur njëra prej *shkronjave të kalkales* gjendet pa vokal në mes ose në fund të fjalës (qoftë për shkak të formës bazore, qoftë për shkak të ndaljes). *Shkronjat e kalkales* janë 5: ط د ح ب .

Shembuj:

الْفَلَقْ أَطْعَمْهُمْ لَمْ يَلِدْ حَاجَجْتُمْ إِذَا وَقَبْ

2. Në qoftë se *shkronja e kalkales* është me *teshidid* (e përforcuar), atëherë, në rast të ndalimit, pas shqiptimit të *teshididit* bëhet edhe *kalkaleja*, pra shqiptohen të dy shkronjat e *kalkales* (e para duke u lexuar me *sukun*, e dyta duke u bërë *kalkale*). P. sh. :

تَبْ (تَبْ) بِالْحَقْ (بِالْحَقْ)

Në rast të kalimit, pra të leximit të lidhur me fjalën pasuese, atëherë *shkronja e kalkales* lexohet normalisht si çdo shkronjë tjeter e përforcuar pa bërë *kalkale*. P. sh. :

أَنْ آدُوا أَخْجُجْ أَشْهُرْ

3. Në qoftë se në një vend gjendet edhe *idgami* edhe *kalkaleja*, atëherë braktiset *kalkaleja* dhe bëhet vetëm *idgami*. P. sh.:

مَا عَبَدْتُمْ (مَا عَبَّتُمْ) أَنِ اضْرِبْ بِعَصَاكَ (أَنِ اضْرِبْعَصَاكَ)
أَلَمْ نَخْلُكُمْ (أَلَمْ نَخْلُكُوكُمْ)

Vendimi i *kalkales*: të gjithë imamët e leximit të Kur'anit kanë bërë *kalkale*, prandaj bërja e saj është **vaxhib**.

Disa çështje që duhen pasur parasysh te *kalkaleja*:

1. Kur ta shqiptojmë *kalkalen*, zërin e saj duhet ta theksojmë fuqishëm sa ta dëgjojë personi që e kemi afër.
2. Kur ta shqiptojmë *kalkalen*, duhet pasur kujdes që atë të mos e lexojmë sikur me *teshidid*. P. sh. fjalën (ﷺ) ta lexojmë sikur (ﷺ).
3. *Kalkalen* nuk duhet bërë lehtë, me qëllim që shkronjën e *kalkales* të mos e shqiptojmë me vokal. P. sh. fjalën (لَا اُفْسِمُ) ta lexojmë sikur (لَا اُفْسِمُ).
4. *Kalkalen* nuk duhet shqiptuar edhe aq fuqishëm, sa të duket kinse pas *shkronjës* së *kalkales* të kishte një *hemze* pa vokal. P. sh. fjalën (ﷺ) ta lexojmë sikur (ﷺ).

PËREMRI PRONOR “Hu” - *DAMIRI*

(الضمير)

Ajo që trajtohet në shkencën e texhvidit është vetëm përemri pronor, njëjës, i vetës së tretë dhe i gjinisë mashkulllore "hu", që vjen në fund të fjalës (هـ - ئـ). Këtij i thuhet edhe *ha'ul-kinajeh*.

Ky përemër lexohet në disa mënyra:

- A. Në rast se ndalojmë te ky përemër, atëherë atë e lexojmë me *sukun*, shkurt pa e zgjatur. P.sh.: لَهُ ، بَهُ ، رَبُّهُ ، مِنْهُ ، عَنْهُ .
- B. Në rast se e vazhdojmë leximin duke kaluar në fjalën vijuese, atëherë ky përemër lexohet në këto dy mënyra:
1. Lexohet duke **e zgjatur** në rast se shkronja para këtij përemri ka vokalin *fet'ha* ("e"), *kesra* ("i") ose *damme* ("u"). Sipas kësaj, nëse ky përemër vetë bart vokalin "u", atëherë pas tij nënkuptohet sikur të ketë një "v" (dhe nëse pas tij nuk ka ndonjë *hemze* si shkak i zgjatjes*) dhe zgjatet sa një *elif miktari* – sa dy vokale. P.sh.:

رَبُّهُ = هُوَ ، رَبُّهُ = بُهُ

Përjashtim bën fjala (لَكُمْ بِرْضَةٌ) te ajeti 7 i sures ez-Zumer sipas imam Asimit. Në këtë rast "hu" nuk zgjatet, porse lexohet shkurt.

Në rast se përemri bart vokalin "i", atëherë pas tij nënkuptohet sikur të ketë një "j" (dhe nëse pas tij nuk ka ndonjë *hemze* si shkak i zgjatjes) dhe zgjatet po ashtu një *elif miktari* – sa dy vokale. P.sh.:

عِلْمِهِ = عِلْمِهِي ، بِهِ = بِهِي

Edhe fjala (هَذِهِ) i nënshtrohet të njëjtit rregull.

Në qoftë se pas një përemri të këtillë vjen *hemzeja* si shkak i zgjatjes (*meddit*), atëherë kemi rregullin që quhet *medd'i-munfasil* dhe ky përemër në këtë rast do të mund të zgjatet se katër *elif miktari*. P.sh.:

بِهِ إِيمَانًا ، عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ

Ky përemër pronor nuk bart asnjeherë vokalin "e".

* Shiko mësimin në vijim "*Meddi* dhe shkaqet e tij".

2. Lexohet duke **mos e zgjatur** në qoftë se ky përemër vetë bart një vokal, kurse shkronja para tij bart shenjën *sukun* (—). P.sh.:

مِنْهُ ، وَاجْتَبَاهُ

Po kështu lexohet shkurtë edhe përemri i cili ndodhet midis dy shkronjave që bartin *sukunin*. P.sh.:

مِنْهُ ابْتَغَاهُ ، يَعْلَمُهُ اللَّهُ

Edhe përemri që pas vetes ka një *sukun*, lexohet shkurt. P.sh.:

لَعَلَّهُ الْمُلْكُ ، لَهُ الْذِينَ

Sipas imam Asimit kemi një përjashtim te fjala (فِيهِ مُهَانًا), ajeti 69 i surest el-Furkan. Këtu edhe pse përemri bart vokal, kurse shkronja para tij është pa vokal, prapëseprapë lexohet gjatë. Sipas rregullit duhej të lexohej shkurt.

Po ashtu edhe te fjalët në vijim kemi shkronjën “h” që i përngjan përemrit pronor “hu”, mirëpo në fakt nuk bëhet fjalë për përemrin pronor, por se këto shkronja “h” janë pjesë përbërëse të fjalëve të cekura:

لَمْ يَنْتَهِ ، لَمْ تَنْتَهِ ، مَا نَفْقَهُ ، فَوَاكِهُ

MEDDI DHE RREGULLAT E TIJ

(أَحْكَامُ الْمَدِ)

Përkufizimi. Fjala *medd* (المَدُ), në aspektin etimologjik do të thotë ‘të zgjatësh’, ‘të shtosh’, kurse si term i texhvidit do të thotë: ‘zgjatje e zërit me anë të njërsës prej *shkronjave të meddit* ose të *linit*’. E kundërta e *meddit* është *kasri* (الْقَصْرُ), respektivisht “shkurtimi” ose “leximi shkurt”.

Shkronjat e meddit janë:

1. *V*-ja (و): kjo shkronjë bëhet *shkronjë e meddit* kur vetë është pa vokal (و), kurse shkronja para saj ka vokalin *u*. Në këtë rast shkronja *v* shërben për ta zgjatur vokalin *u* që është para saj. P. sh. :

تُوبُوا (tuubuu) قُولُوا (kuuluu) أَعُوذُ (e'uudhu)

2. *J*-ja (ي): kjo shkronjë bëhet *shkronjë e meddit* kur vetë është pa vokal (ي), kurse shkronja para saj ka vokalin *i*. Në këtë rast shkronja *j* shërben për ta zgjatur vokalin *i* që është para saj. P. sh. :

قِيلَ (kiile) سِيقَ (siika) الْأَذِي (el-ledhii)

3. Elifi (إ): gjithnjë është një shkronjë pa vokal. Kur para saj qëndron shkronja me vokalin *e*, atëherë kjo bëhet *shkronjë meddi* dhe vokalin para saj e zgjat në *aa*. P. sh.:

قَالَ (kaale) كَانَ (kaane) إِذَا (idhaa)

Duke qenë specifike vetëm për shkrimin e Mus'hafit (Kur'anit), *elifat* që ndodhen në fund të disa fjalëve, janë shkruar me *v* ose *j*. P. sh.:

رِلْفَى (رِلْفَى) كَفَى (كَفَى) الْزَّكْوَةُ (الْزَّكْوَةُ) الْصَّلَاةُ (الْصَّلَاةُ)

Shkaqet e meddit (أَسْبَابُ الْمَدِ). *Shkak i meddit* quhet shkaku i cili kërkon shtimin (zgjatjen) përtej *meddit aslij* (*meddit tabij*). Këto shkaqe janë dy: *hemzeja* (أَهْمَزَةُ) dhe *sukuni* (أَسْكُونُ).

1. *Hemzeja* (ء ، ا) është njëra prej shkronjave bazë të gjuhës arabe. Kur *hemzeja* vjen pas ndonjërs prej *shkronjave të meddit*, atëherë bëhet *shkak i meddit* dhe shkronjën para saj e zgjat më tepër se *një elif miktari*. P. sh. :

سُوءٌ يَشَاءُ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ

2. *Sukuni* (السُّكُونُ) do të thotë mungesë e zanores (vokalit). Një shkronje që nuk bart ndonjë zanore (vokal ose *hareke*) i vendohet shenja e *xhezmit* (ؘ) dhe kjo shkronjë në këtë gjendje quhet *sakin*. *Sukuni* ndahet në dy pjesë:

a. *Sukunu lazim* (السُّكُونُ الْلَازِمُ): është *sukuni* i cili mbetet i tillë e nuk ndryshon edhe kur ndalemi në të po edhe kur kalojmë në fjalën pasuese. P. sh. : آلآن ق (فَافْ) جَانَ (جَانْ)

b. *Sukunu arid* (السُّكُونُ الْعَارِضُ): është *sukuni* i cili kur ndalemi tek ai duket e shqiptohet, e kur të kalojmë në fjalën pasuese atëherë ai zhdukjet, gjegjësisht është *sukuni* i cili paraqitet vetëm me rastin e ndaljes. P. sh. :

(يَعْلَمُونْ) يَعْلَمُونَ . (يَوْمَ الدِّينِ) يَوْمَ الدِّينِ . (نَسْتَعِينُ) نَسْتَعِينُ

Ndarja e *meddit*: Kryesisht ndahet në dy pjesë: *aslif* dhe *fer'ij*.

1. *Meddi aslij* (الْمَدُّ الْأَصْلِيُّ): është *meddi* i cili formohet me njëren prej *shkronjave të meddit* dhe që nuk mbështetet në ndonjë *shkak* tjetër të *meddit*. Ndryshe ky quhet edhe *meddi tabi'ij* (الْمَدُّ الظَّبِيعِيُّ). Shih më poshtë!

2. *Meddi fer'ij* (الْمَدُّ الْفَرْعَعِيُّ): është *meddi* i cili paraqitet si pasojë e ndonjë *shkaku* të *meddit* i cili shkakton shtimin, zgjatjen përtej *meddit aslij*. Ky lloj i *meddit* ndahet në 5 pjesë: *muttasil*, *munfasil*, *lazim*, *arid* dhe *liin*.

Tani t'i shohim me radhë të gjitha këto lloje të *meddit* (zgjatjes)!

A) MEDDI TABI'IJ (ZGJATJA E NATYRSHME)

(الْمَدُّ الطَّبِيعِيُّ)

Meddi tabi'ij bëhet kur në një fjalë ndodhet ndonjëra prej *shkronjave tē meddit* (أَيْ وَ أَيْ), por që nuk ndodhet asnëri prej *shkaqeve tē meddit* (*hemzeja apo sukuni*). P. sh.:

نُوحِيَهَا - nuuhiihaa أَبَدَا - ebedaa

Te shembulli (نُوحِيَهَا) kemi *shkronjë tē meddit* v-në (و) e cila e zgjat shkronjën *n* me vokalin *u* (ۇ), kemi shkronjën *j* (ى) e cila e zgjat shkronjën *h* me vokalin *i* (ى) dhe kemi shkronjën *elif* (إ) e cila e zgjat shkronjën *h* me vokalin *e* (ئ). Meqë mbas këtyre *shkronjave tē meddit* nuk ndodhet asnë *shkak i meddit*, atëherë këtu realizohet *meddi tabi'ij*.

Edhe pse te disa fjalë *shkronja e meddit* nuk shihet, pra nuk është e shkruar, përsëri ato fjalë lexohen me zgjatje sikur të kishin *meddin tabi'ij*. Në këto raste *shkronja e meddit* është e fshehur dhe supozohet se në fakt ekziston – *harfi medd takdirij*.

P. sh. : لَهُ - lehuu بِهِ - bihii آمَنَ - aamene

Kohëzgjatja e meddit tabi'ij është sa një *elif mikdari*.

(‘*Një elif mikdari*’ do tē thotë ta zgjatësh zërin aq sa tē lexosh dy zanore – afërsisht sa një sekondë, gjegjësisht sa tē thuhet fjala ‘*elif*’ ose sa tē ngrihet e lëshohet gishti i dorës).

Nuk lejohet leximi më i shkurtër ose më i gjatë i *meddit tabi'ij*, d. m. th. është **vaxhib** zgjatja e paraparë për tē.

B) MEDDI MUTTASIL (ZGJATJA E NGJITUR)

(الْمَدُّ الْمُتَّصِلُ)

Meddi muttasil bëhet kur, në një fjalë të vetme, pas ndonjërës prej shkronjave të meddit (و ی) vjen ngjitas *hemzeja* (ء) si shkak i meddit.

P. sh. : يَشَاءُ - jeshaa'u حَيَّةٌ - xhii'e سُوَّةٌ - suu'e

Te shembulli (يَشَاءُ) *shkronja e meddit* që është *elifi* (۱), e zgjat shkronjën *sh* (ش). Menjëherë pas saj ka ardhur *hemzeja* dhe meqë të dyja gjenden në një fjalë, pranë njëra-tjetrës, formojnë *meddin muttasil* (*zgjatjen e ngjitur, e lidhur*).

Vendimi për *meddin muttasil* shqyrtohet në dy pozita.

1. Të gjithë imamët e leximit të Kur'anit janë të një mendimi se *meddi muttasil* duhet zgjatur më tepër se *meddi tabi'ij* dhe ky vendim është **vaxhib**.
2. Imamët e leximit të Kur'anit nuk janë të një mendjeje sa i përket sasisë se sa duhet zgjatur *meddi muttasil*. Koha sa duhet zgjatur ajo është **xhaiz** (e lejueshme) prej 1 deri më 4 elifa mbi *meddin tabi'ij*. Sipas imamit tonë, Asimit, *meddi muttasil* lexohet duke i shtuar *meddit tabi'ij* 3 elifa, pra gjithsejt 4 *elif mikdari*.

C) MEDDI MUNFASIL (ZGJATJA E NDARË)

(الْمَدُّ الْمُنْفَصِلُ)

Meddi munfasil bëhet kur njëra prej shkronjave të meddit vjen në fund të fjalës, kurse në fillim të fjalës vijuese vjen *hemzeja* si *shkak i meddit*. P. sh. :

يَا آئُهَا

إِنِّي أَخَافُ

تُوبُوا إِلَى اللَّهِ

Te shembulli (يَا آئُهَا), është elifi si *shkronjë e meddit* i cili e zgjat shkronjën *j* të vokalizuar me *e*, kurse në fillim të fjalës (آئُهَا) ndodhet *hemzeja* (elifi) si *shkak i meddit* dhe të dyja këto, edhe elifi edhe hemzeja ndodhen pranë njëra-tjetrës por në fjalë të ndryshme e jo në një fjalë të vetme, prandaj edhe kemi realizimin e *meddi munfasilit*.

Në disa raste të *meddi munfasilit*, *shkronja e meddit* nuk është e shkruar, por ajo supozohet të jetë prezente, prandaj edhe këtu kemi *meddi munfasil*. P. sh.

أَنَّ مَالَةً (و) أَخْلَدَهُ عِنْدَهُ (و) إِلَّا بِإِذْنِهِ إِنَّ هَذِهِ (بَهْ) إِيمَانًا

Te dy shembujt e parë kemi *shkronjën e supozuar të meddit* (و), kurse te dy të fundit *shkronjën e supozuar të meddit* (ى), të cilat e zgjasin shkronjën *h*. Për këtë më gjerësisht shiko te *Damiri*, faqe 20-21.

Meqë *meddi munfasili* bëhet me ardhjen e dy fjalëve pranë njëra-tjetrës, atëherë duhet që këto dy fjalë të lidhen me njëra-tjetrën.

Në qoftë se ndalemi te fjala e parë e cila ka *shkronjën e meddit* dhe nuk kalojmë te fjala tjetër, atëherë këtu kemi vetëm *meddi tabi'ij*. Ta marrim për shembull fjalën (إِنِّي أَخَافُ). Nëse detyrohemi të ndalemi, për shkak të mungesës së

frymës gjatë leximit, te fjala (إِنِّي), atëherë këtë fjalë e zgjatum sa *meddi tabi'ij* dhe ndalemi.

Vendimi për *meddin munfasil*: imamët e leximit të Kur'anit nuk janë të një mendimi për sa i përket asaj se duhet apo nuk duhet zgjatur *meddi munfasili*, po edhe në qoftë se zgjatet sa duhet zgjatur. Do të thotë se vendimi për këtë është **xhaiz (i lejueshëm)**, mund ta zgjatum po mund edhe të mos e zgjatum fare. Në qoftë se e zgjatum mund ta bëjmë këtë prej 1 deri në 4 *elif mikdari*. Sipas leximit të imamit Asim, *meddi munfasil* zgjatet gjithsej 4 *elif mikdari* (1+3).

Ç) MEDDI LAZIM (ZGJATJA E DOMOSDOSHME)

(الْمَدُّ الْلَّازِمُ)

Meddi lazim bëhet kur në një fjalë të vetme vijnë pranë njëra-tjetrës njëra prej shkronjave të meddit (ي و ا) dhe sukunu *lazimi* (ة) që është prej shkaqeve të meddit (shih më lart lidhur me *shkaqet e meddit!*). P. sh. :

مُدْهَامَتَانِ (مُدْهَامَتَانِ) دَاهْبَةٌ (دَاهْبَةٌ) آلَانَ (آلَانَ)

Ndarja e *meddit lazim*:

Meddi lazim ndahet në 4 pjesë dhe kjo ndarje është bërë në bazë të asaj nëse *meddi lazim* bëhet në fjalë apo në shkronjë dhe në bazë të asaj nëse fjala ose shkronja është me *teshidid* (ـ) ose pa të.

1. *Meddi lazim kelimei muthekkaleh* (الْمَدُّ الْلَّازِمُ عِنْدَ الْكَلِمَةِ الْمُثَقَّلَةِ): do të thotë ,zgjatje e domosdoshme e fjalës së rëndë'. Bëhet kur pas njërsës prej shkronjave të meddit vjen sukunu *lazimi* si *shkak i meddit* por i përforcuar, me *teshidid*. P.sh.:

تَامُرُونِيٌّ صَافَةٌ الْحَقَّةُ

Te shembulli (الْحَقَّةُ), është elifi si shkronjë e meddit e cila e zgjat shkronjën *h* (ح). Pas kësaj vjen shkronja *k* me *teshidid* (قـ) dhe meqë të dyja ndodhen pranë njëra-tjetrës në një fjalë të vetme, këtu realizohet *meddi lazim*.

Në qoftë se shkronja e meddit dhe *sukuni* ndodhen pranë njëra-tjetrës por në fjalë të ndryshme, atëherë nuk kemi *meddi lazim*. P. sh. :

إِذَا الشَّمْسُ وَالْمُقِيمِي الصَّلَوةُ قَالُوا اخْنَذَ اللَّهُ

2. *Meddi lazim kelimei muhaffefeh* (الْمَدُ اللَّازِمُ عِنْدَ الْكَلِمَةِ الْمُخَفَّفَةِ): do të thotë ‘zgjatje e domosdoshme e fjalës së lehtë’. Bëhet kur pas *shkronjës* së *meddit* vjen *sukunu lazimi* si *shkak i meddit* me *xhezëm* (ظ). P. sh.: آلآن.

Te ky shembull, ajo që e zgjat elifin e parë është një elif i supozuar e që nuk shkruhet (ت = ا ء), prandaj edhe lexohet ‘aa’ (ئ). Pas këtij elifi vjen shkronja *l* me *xhezëm* (ل) dhe meqë të dyja gjenden në një fjalë të vetme, këtu realizohet *meddi lazim*.

3. *Meddi lazim harfi muthekkal* (الْمَدُ اللَّازِمُ عِنْدَ الْحُرْفِ الْمُشَقَّلِ): do të thotë ‘zgjatje e domosdoshme e shkronjës së rëndë’. Bëhet kur pas *shkronjës* së *meddit* vjen *sukuni lazim* si *shkak i meddit*, por me *teshidid*.

Ky lloj i *meddit lazim* ndodhet vetëm te shkronjat e quajtura ‘hurufu’l-mukatta’ah’ (الْحُرُوفُ الْمُقَطَّعَةُ) të cilat ndodhen në fillim të disa sureve të Kur'anit fisnik. P. sh.: المَصْ - طَسْمَ - الْمَرْ - الْمَ - ل .

Shembulli (لـ ، شَقِيقٌ لَامْ مِيمٌ) , shqiptohet kështu (الْأَلْفُ لَامْ مِيمٌ) . Këtu elifi si *shkronjë e meddit* e zgjat shkronjën *l* (ل) dhe menjëherë mbas saj ka ardhur shkronja *m* me *teshidid* (مـ). Edhe shembujt e tjerë janë të këtillë:

الْمَرْ - الْأَلْفُ لَامْ مِيمٌ رَا - الْأَلْفُ لَامْ مِيمٌ طَسْمَ - طَسِيمِيْمِ رَا

الْمَصْ - الْأَلْفُ لَامْ مِيمٌ صَادْ - الْأَلْفُ لَامْ مِيمٌ صَادْ

4. *Meddi lazim harfi muhaffef* (الْمَدُ اللَّازِمُ عِنْدَ الْحُرْفِ الْمُخَفَّفِ): do të thotë ‘zgjatje e domosdoshme e shkronjës së lehtë’. Bëhet kur pas *shkronjës* së *meddit* vjen *sukunu lazimi* si *shkak i meddit*, por me *xhezëm* (ظ). Edhe ky lloj i *meddit lazim* vjen te të ashtuquajturat “hurufu’l-mukatta’ah”. P. sh. :

الْمَ - الْرَّ - طَسْمَ - الْمَرْ - حَمْ

Shembulli (أَمْ لَامْ مِيمْ) shqiptohet kështu (أَلْفُ لَامْ مِيمْ), kurse duhet lexuar kështu (أَلْفُ لَامْ مِيمْ). Te pjesa (مِيمْ) është *shkronja e meddit* *j* (ى) ajo që e zgjat *m*-në e parë, kurse pas saj vjen shkronja *m* me *xhezëm* (مْ). Këtu *shkronjë e lehtë* është *m*-ja e dytë. E njëjtë vlen edhe te shembujt e tjerë:

الْمَر - أَلْفُ لَامْ مِيمْ رَا - أَلْفُ لَامْ مِيمْ مِيمْ - طَاسِيْمِيمْ

الْر - أَلْفُ لَامْ رَا - أَلْفُ لَامْ رَا حَم - حَامِيمْ - حَامِيمْ

Vendimi për *meddin lazim*: të gjithë imamët e leximit të Kur'anit janë të një mendimi se *meddi lazim* duhet zgjatur edhe atë 3 elifa mbi *meddin tabi'ij*, gjegjësisht të zgjatet gjithsej 4 *elif mikdari*.

D) MEDDI ARID (ZGJATJA JO E PËRHERSHME)

الْمَدُّ الْعَارِضُ

Meddi aridi bëhet kur pas *shkronjës së meddit* vjen *sukunu aridi* si *shkak i meddit* dhe të dyja këto ndodhen pranë njëra-tjetrës në një fjalë të vetme. P. sh.:

نَسْتَعِينُ (نَسْتَعِينُ) . يَوْمُ الدِّينِ (يَوْمُ الدِّينِ) . الْعَالَمِينَ (الْعَالَمِينَ)

Më lart përmendëm se *sukunu aridi* paraqitet kur ndalemi në *shkronjën* e fundit të ndonjë fjale, e kur të lidhemi me fjalën vijuese pa u ndalur tek ajo atëherë ajo ngrihet e zhduket. Te shembulli الْعَالَمِينَ (*الْعَالَمِينَ*), vokali i *shkronjës së fundit*, *n-së* është *e*. Po qe se ndalemi te kjo *shkronjë*, atëherë *shkronja n* nuk do të lexohet me vokalin *e* (*ne-* نَ), porse me *sukun* (ن = *n*). Do të thotë që *shkronjës n* i japim një *sukun jo* të *përhershëm*. Prandaj, ky *medd* quhet *meddi arid* (*medd jo i përhershëm*). Po qe se këtë fjalë e lidhim me fjalën që vjen pas saj, kësaj radhe do të ngrihet *sukuni* (ن) prej *shkronjës n* dhe ajo do të lexohet me

vokalin bazë që e ka e që në këtë rast është vokali *e*, pra sërish do të lexohet *ne*. E njëjtë vlen edhe me shembujt e tjerë.

Vendimi për *meddin arid*: imamët e leximit të Kur'anit, këtë *medd* e kanë lexuar dhe zgjatur në disa mënyra, prandaj vendimi është **xhaiz (i lejueshëm)**, pra mund të lexohet në ndonjërën prej mënyrave si më poshtë:

1. Po qe se vokali bazë i shkronjës së lexuar me *sukunu arid* është *e*, është e lejueshme që ky *medd* të lexohet në këto tri mënyra: (الْعَالَمِينَ)

- a) *Tuul* (gjatë) – 4 *elif mikdari*,
- b) *Tevassut* (mesatare) – 2-3 *elif mikdari*,
- c) *Kasr* (shkurtë) – 1 *elif mikdari*.

2. Po qe se vokali bazë i shkronjës së lexuar me *sukunu arid* është *i*, është e lejueshme që ky *medd* të lexohet në këto katër mënyra: (يَوْمُ الدِّينِ).

- | | |
|----------------------|---------------------------|
| a) <i>Tuul</i> , | c) <i>Kasr</i> , |
| b) <i>Tevassut</i> , | ç) <i>Kasr me reum2</i> . |

3. Po qe se vokali bazë i shkronjës së lexuar me *sukunu arid* është *u*, është e lejueshme që ky *medd* të lexohet në këto shtatë mënyra: (نَسْتَعِينُ).

- | | |
|-----------------------------|--------------------------------|
| a) <i>Tuul</i> , | d) <i>Tevassut me ishmam</i> , |
| b) <i>Tevassut</i> , | dh) <i>Kasr me ishmam</i> , |
| c) <i>Kasr</i> , | e) <i>Kasr me reum</i> . |
| ç) <i>Tuul me ishmam3</i> , | |

² *Revmi* në texhvid definohet kështu: 'Lexim i vokalitzanores me një zë të ulët'. Pra, *reum* do të thotë lexim i vokalit të shkronjës së fundit ku ndalemi, me një fuqi të 1/3 së zërit. *Revmi* bëhet te voalet *i* dhe *u*. Arsyja e *reumit* është për t'i bërë me dije njeriut që është i verbër se çfarë vokali ka shkronja e fundit e fjalës tek e cila jemi ndalur.

³ *Ishmami* (الإِشْمَامُ اِنْصِمَامُ الشَّفَقَتَيْنِ بَعْدَ السُّكُونِ إِشَارَةً إِلَى الضَّمِّ) është 'mbledhje e buzëve përpara për të treguar në vokalin *u* që vjen pas *sukunit*'. Pra, *ishmami* nënkupton mbledhjen (tkurrjen) e buzëve duke i nxjerrë përpara për të sinjalizuar vokalin *u* pa nxjerrë ndonjë zë dhe pasi ta kemi lexuar me *sukun* shkronjën e cila është në fund të fjalës. Në këtë rast buzët do të marrin pozitën sikur ta shqiptojmë vokalin *u* ose shkronjën *v*. *Ishmami* bëhet vetëm te vokali *u*. Shërben për t'i bërë me dije njeriut të verbër se vokali i shkronjës së fundit të fjalës është *u*. (Më tepër për këto duhet mësuar nga ekspertët e shkencës së texhvidit).

DH) MEDDI LIIN (ZGJATJA E BUTË)

(الْمَدُّ الِّيْنُ)

Meddi liini bëhet kur pas *shkronjës së liinit* vjen *sukuni* si *shkak i liinit* dhe kur që të dyja këto gjenden në një fjalë të vetme. *Shkronja e liinit* do të thotë ‘shkronja e butë’ dhe bëhet kur shkronja *v* dhe *j* janë me *sukun*, kurse shkronja para tyre është me vokalin *e* (ء). P. sh. :

أَلْيَوْمُ وَالظَّيْرُ عَلَى عَقِبَيْهِ وَلَا نَوْمٌ وَلَا حَوْفٌ

Vendimi për *meddi liinin*: shqyrtohet në dy pozita:

- Nëse pas *shkronjës së liinit* vjen *sukunu lazimi*, atëherë është **e lejueshme** që këtë ta lexojmë në dy mënyra: *Tuul* dhe *tevassut*.
- Nëse pas *shkronjës së liinit* vjen *sukunu aridi*, atëherë trajtohet e lexohet sikurse *meddi aridi*: Nëse vokali i shkronjës në të cilën ndodhet *sukunu aridi* është *e*, mund të lexohet në tri mënyra, nëse është *i* mund të lexohet në katër mënyra, e nëse është *u* mund të lexohet në shtatë mënyra.*

Siç pamë më lart, kohëzgjatja e *meddi liinit* ndryshon nga lloji i *sukunit*. Sipas kësaj:

1. Nëse *sukuni* është *sukunu lazim*, atëherë është e lejuar të lexohet në dy mënyra:

- Tuul* (3 *elif mikdari*),
- Tevassut* (2 *elif mikdari*)

Në Kur'anin fisnik kësi lloji të *meddi liinit* haset në dy vende: Në fillim të sures Merjem (كَهِيْعَصَ), shprehja (عَيْنُ) dhe në fillim të sures Shu'ara (حَمٌ . عَسْقٌ),

shprehja (عَيْنُ). Të dyja këto shprehjet (عَيْنُ) është parapëlqyer të lexohen me *tuul*.

2. Nëse *sukuni* është *sukunu arid*, atëherë, varësisht prej vokalit që ka shkronja në të cilën gjendet *sukunu aridi*, është e lejuar të lexohet në këto mënyra:

* Shih më lart te *meddi aridi*!

a) Nëse vokali bazë i shkronjës në të cilën ndodhet *sukunu aridi* është *e*, p.sh. (اليوم . عليك . عَلَيْكُ), mund të lexohet në tri mënyra:

- aa. *Tuul* (3 *elif mikdari*),
- ab. *Tevassut* (2 *elif mikdari*),
- ac. *Kasr* (1 *elif mikdari* ose aspak nuk zgjatet).

b) Nëse vokali bazë i shkronjës në të cilën ndodhet *sukunu aridi* është *i*, p. sh. (والصيف . عينين . عَيْنَيْنِ), mund të lexohet në katër mënyra:

- | | |
|-----------------------|---------------------------|
| ba. <i>Tuul</i> , | bc. <i>Kasr</i> , |
| bb. <i>Tevassut</i> , | bç. <i>Kasr me reum</i> . |

c) Nëse vokali bazë i shkronjës në të cilën ndodhet *sukunu aridi* është *u*, p. sh. (لَا نَوْمٌ . وَلَا نَبْيَعٌ . لَا بَيْغٌ), mund të lexohet në shtatë mënyra:

- | | |
|-----------------------------|---------------------------------|
| ca. <i>Tuul</i> , | cd. <i>Tevassut me ishmam</i> , |
| cb. <i>Tevassut</i> , | cdh. <i>Kasr me ishmam</i> , |
| cc. <i>Kasr</i> , | ce. <i>Kasr me reum</i> . |
| cc. <i>Tuul me ishmam</i> , | |

Dallimet midis *meddi liinit* dhe *meddeve* të tjera:

1. Te *meddi liini*, *meddi* – pra, procesi i zgjatjes – bëhet mbi *shkronjën e liinit*. Kurse te *meddet* e tjera, bëhet sipas vokalit të shkronjës e cila ndodhet para *shkronjës së meddit*.
2. Te *meddi liini*, masat e zgjatjes janë më të shkurtra se te *meddet* e tjera. Te *meddet* tjera, *tuuli* është 4-5 elifa (sipas leximit të Asimit 4 elifa), *tevassuti* është 2-3 elifa, kurse *kasri* është 1 elif. Së këndejmi, te *meddi liini*, *tuuli* është 3 elifa, *tevassuti* është 2 elifa, kurse *kasri* është 1 elif ose aspak nuk zgjatet.

IDGAMI DHE RREGULLAT E TIJ

(الْإِدْغَامُ وَ الْحَكَامُ)

Definicioni i idgemit në shkencën e texhvidit është:

الْإِدْغَامُ: إِدْخَالُ أَحَدِ الْحُرْفَيْنِ الْمُتَمَاثِلَيْنِ أَوِ الْمُتَجَانِسَيْنِ أَوِ الْمُتَقَارِيْنِ فِي الْآخِرِ

"Idgam do të thotë hyrja ose shkrirja e njëres prej dy shkronjave të njëja, të njëllota ose të përaferta në tjetrën".

Pjesët përbërëse të idgemit:

1. *Mudgami* (المُدْغَمُ): quhet shkronja e parë me *sukun* e cila do të shkrihet në të dytën.
2. *Mudgamun fih* (المُدْغَمُ فِيهِ): quhet shkronja e dytë në të cilën shkrihet e para me *sukun*.

Shembull: (قُلْنَ = قُلْنٌ). Këtu, *mudgam* është shkronja *l* me *sukun* (لُ), kurse *mudgamun fih* është shkronja *l* me vokalin *e* (لِ).

Kushtet e idgemit:

Që të mund një shkronjë të shkrihet në tjetrën që vjen pas saj, duhen plotësuar këto katër kushte:

1. Shkronjat që do të shkrihen duhet të janë të njëja (*mutemathil*), të të njëjtit lloj (*mutexhanis*), ose të përaferta (*mutekarib*).
2. *Mudgami* dhe *mudgamun fih* duhet të janë pranë njëri-tjetrit dhe në mes tyre të mos hyjë ndonjë shkronjë tjeter.
3. *Mudgami* duhet të jetë *sakin*, kurse *mudgamun fih* duhet të jetë i vokalizuar. Në shembujt më poshtë nuk kemi *idgam* (shkrirje), ngase nuk plotësohet ky kushti i tretë:

ضَلَّنَا - ظَنَنْتُمْ - لَا تَفْصِصُنْ

4. *Mudgami* nuk duhet të jetë shkronjë e *meddit*. P. sh.:

الَّذِي يُوسِسُ - فِي يَوْمٍ - قَالُوا وَهُمْ - آمَنُوا وَعَمِلُوا

Te këta shembujt e fundit nuk mund të bëhet *idgam*, sepse te dy shembujt e parë kemi shkronjën *j* si *shkronjë tē meddit*, kurse te dy të fundit shkronjën *v* si *shkronjë tē meddit* dhe elifin si të tepërt që bën ndarjen e tyre me çka nuk plotësohet kushti i dytë.

Shkaku i *idgaminit*. *Idgami* bëhet për shkakat të njëjtësisë (*temathul*), ose të njëllojshmërisë (*texhanus*), ose të përafërsisë (*tekarub*) që ekziston midis *mudgaminit* dhe *mudgamun fihit*.

Llojet e *idgaminit* sipas mënyrës së realizimit:

1. *Idgami i plotë* (الْأَدْعَامُ التَّامُ): quhet *idgami* në të cilin *mudgami* shkrihet tërësisht me gjithë veten dhe vetitë e tij në *mudgamun fihi* dhe të dyja këto lexohen sikur të ishin një shkronjë e vetme e përforcuar me *teshidid*. Shembuj:

قَدْ تَبَيَّنَ (قَتَّبَيْنَ) إِذْ ذَهَبَ (إِذْهَبَ) إِذْ ظَلَمُوا (إِظْلَمُوا)

2. *Idgami jo i plotë* (الْأَدْعَامُ النَّاقِصُ): quhet *idgami* në të cilin *mudgami* vetë shkrihet në *mudgamun fihi*, por nuk shkrihen edhe vetitë e tij, pra sado pak e tregojnë veten gjatë leximit. P. sh.:

لَئِنْ بَسَطْتَ (لَئِمْبَسَطْتَ) مَنْ يَعْمَلْ (مَنْ يَعْمَلْ)

Te këta dy shembuj duhet të kishit vërejtur se te format e shkruara brenda kllapave, që është mënyra se si ato lexohen, nuk i kemi shkrirë tërësisht shkronjat *t* (ط) dhe *n* (ن). Ato i kemi lënë pa kurrfarë shenje, që duam të themi se ato gjatë leximit me *idgam* nuk shkrihen tërësisht në shkronjat *t* (ت) dhe *j* (ج) që vijnë pas tyre. Sikur të shkriheshin tërësisht në to, do t'i kishim shkruar në kllapa kështu: (مَيَعْمَلْ) ، (لَئِمْبَسَتْ) . Prandaj edhe quhet *idgam nakis* (*shkrirje jo e plotë*).

Degëzimi i *idgamt* përgjithësisht:

Varësish prej pozitës së *mudgamit* dhe *mudgamun fihit*, *idgami* ndahet në gjashtë degë:

- | | |
|--------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Idgam mea'l-gunneh</i> , | 4. <i>Idgam mutexhanisejn</i> , |
| 2. <i>Idgam bila gunneh</i> , | 5. <i>Idgam mutekaribejn</i> , |
| 3. <i>Idgam mithlejn</i> , | 6. <i>Idgam shemsije</i> . |

Për dy degët e para të *idgamt* (*idgam mea'l-gunneh* dhe *idgam bila gunneh*) kemi folur më lart kur e kemi trajtuar çështjen e *tenvinit* dhe *nunit sakin*. Kurse për llojet e tjera të *idgamt* do të bëjmë fjalë në vazhdim.

1. IDGAMI MITHLEJN (إِذْغَامُ الْمِثْلَيْنِ)

Idgami mithlejn bëhet kur dy shkronja tē njëta pér nga vetitë dhe artikulimi vijnë njëra pas tjetrës, prej tē cilave e para është me *sukun*, kurse e dyta me vokal-zanore. Shembuj:

مِنْ نَارٍ ، فَمَا رَبَحْتُ تَحْارَثُهُمْ ، قَدْ دَخَلُوا ، إِنَّ رَبِّ حَقٌّ

Siç shihet te shembujt e mësipërm, *idgami mithlejn*, mund tē realizohet edhe te dy fjalë tē ndryshme, po edhe te një fjalë e vetme.

Idgami mithlejn ndahet në dy pjesë:

1. *Idgami mithlejn mea'l-gunneh* (إِذْغَامُ الْمِثْلَيْنِ مَعَ الْغُنْنَةِ): bëhet kur pas shkronjës *m* tē pavokalizuar vjen një *m* e vokalizuar dhe kur pas shkronjës *n* tē pavokalizuar vjen një *n* e vokalizuar. P. sh. :

وَ مَنْ نُعَمِّرُهُ ، وَ هُمْ مِنْ ، صُمُّ (صُمُّمُ) ، إِنَّمَا (إِنَّمَا)

Kur këta shembuj t'i lexojmë me *idgam*, pér ta treguar vetinë e *gunnes* (leximit ndërhhundë) tē shkronjave *m* dhe *n*, ata duhen zgjatur 1 *elif mikdari* e gjysmë (satrë vokale).

2. *Idgami mithlejn bila gunneh* (إِذْغَامُ الْمِثْلَيْنِ بِلَا الْغُنْنَةِ): është *idgami* (shkrirja) i të gjitha shkronjave tē njëta, pérpos shkronjave *m* dhe *n*. P. sh.:

أَعِدَّتْ (أَعِدَّتْ) ، رَبَّنَا (رَبَّنَا) ، إِذْ ذَهَبَ ، يُدْرِكُمْ

Idgami mithlejn bila gunneh **nuk** zgjatet.

Siç do tē shihet edhe nga shembujt e mëposhtëm, në qoftë se shkronja e parë është *shkronjë e meddit*, në këso raste nuk bëhet *idgam*. P. sh. :

الَّذِي يُوَسِّعُ ، فِي يَوْمٍ آمَنُوا وَ عَمِلُوا

2. IDGAMI MUTEXHANISEJN (اِدْغَامُ الْمُتَحَانِسَيْن)

Idgami mutexhanisejn bëhet kur dy shkronja me artikulim të njëjtë por me veti të ndryshme vijnë njëra pas tjetrës, e para me *sukun* dhe e dyta me vokal.

Sipas transmetimit të Hafsit në leximin e Asimit, *shkronjat mutexhanis* përmblidhen në tri grupe:

1. Shkronjat د , ط dhe ت : kur t'i plotësojnë *kushtet e idgamt* (shih më lart për *kushtet e idgamt*), këto shkronja shkrihen në njëra-tjetër. P. sh. :

مَا عَبَدْنَا (مَا عَبَّتُمْ) ، وَ قَالَتْ طَائِفَةٌ (وَ قَالَطَائِفَةُ) ، لَئِنْ بَسَطْتَ (لَئِمْبَسَطْتَ)
أَخْطُثُ (أَخَطَّتُ)

Te dy shembujt e parë kemi *idgam tē plotē*, kurse te shembujt e dytë (لَئِنْ بَسَطْتَ)
dhe (أَخْطُثُ) kemi *idgam jo tē plotē*.

2. Shkronjat ظ , ذ dhe ث : edhe këto kur t'i plotësojnë *kushtet e idgamt*, shkrihen në njëra-tjetër. P. sh. :

إِذْ ظَلَمُوا (إِظْلَمْتُمْ) ، يَلْهَثْ ذَلِكَ (يَلْهَذَّلِكَ) ، إِذْ ظَلَمْتُمْ (إِظْلَمْتُمْ)

Te këta shembuj kemi *idgam tē plotē*.

3. Shkronjat ب dhe م : kur pas shkronjës *b* me *sukun* (بْ) vjen shkronja *m* me vokal, atëherë shkronja *b* shkrihet në *m*. Në Kur'an ka vetëm një shembull të këtillë në suren Hud-11, ajeti 12:

يَا بُنَيَّ ارْكَبْ مَعَنَا (يَا بُنَيَّ ارْكَمَّعَنَا)

Këtu kemi *idgam tē plotē* dhe zgjatet 1 *elif mikdari* e gjysmë.

Po qe se ndodh e kundërtë, pra shkronja *m* me *sukun* të vijë në fillim e pas saj të vijë shkronja *b* me vokal, atëherë kemi *ihfa* (shih më lart te *Rregullat e mimit sakin*, f. 14) e jo *idgam mutexhanisejn* . P. sh. : أَمْ بِهِ .

(اِدْعَامُ الْمُتَقَارِبَيْنِ) 3. IDGAMI MUTEKARIBEJN

Idgami mutekaribejn bëhet kur dy shkronja me artikulim ose veti të përafërtë vijnë njëra pas tjetrës, e para me *sukun* dhe e dyta me vokal.

Sipas leximit të Asimit, *shkronjat mutekarib* mblidhen në dy grupe:

1. Shkronjat ل dhe ر : midis këtyre dy shkronjave ekziston afërsi edhe për nga artikulimi i përgjithshëm edhe për nga vetitë e tyre. Në qoftë se pas shkronjës *l* me *sukun* (ل) vjen shkronja *r* me vokal, atëherë *l*-ja shkrihet në shkronjën *r*.

P. sh. :

بَلْ رَفِعَةُ اللَّهُ (بَرَّافَعَةُ اللَّهُ) قُلْ رَبُّ (قُرَّابُ)

Në qoftë se së pari vjen shkronja *r* me *sukun* (ر) e pastaj shkronja *l* me vokal, atëherë nuk bëhet *idgam*. P. sh. : اَغْفِرْ لِي ، وَاسْتَغْفِرْ لِذَنِبِكَ .

2. Shkronjat ق dhe ك . Edhe te këto dy shkronja ka afërsi artikulimi dhe vetish.

P. sh. : آمَنَ تَحْلِيقُكُمْ . Te ky shembull, *idgami* që do të bëhet, mund të bëhet edhe *i plotë* edhe *jo i plotë*, mirëpo preferohet *idgami i plotë*.

Forma e *idgamit tē plotë* do të ishte (آمَنَ تَحْلِيقُكُمْ), kurse forma e *idgamit jo tē plotë* do të ishte (آمَنَ تَحْلِيقُكُمْ).

LAMUT-TA'RIFI DHE RREGULLAT E TIJ

Lamut-ta'rifi është një parashtesë (nyje) e përbërë prej shkronjave *elif* dhe *l* (ال), e cila në gjuhën arabe shërben për t'i shquar emrat.

Shkronja *l* (ل) e kësaj nyje, varësisht se çfarë shkronjash vijnë pas saj, lexohet ose me *idgam* ose me *idh'har*. Prandaj edhe shkronjat (bashkëtingëlloret) e gjuhës arabe ndahen në: *shemsijje* (diellore) dhe *kamerijke* (hënore).

A) IDGAMI SHEMSIJJE (الأدغام الشمسية)

Idgami shemsijje bëhet kur pas nyjës shquese (ال) vjen ndonjëra prej shkronjave *shemsijje*. Me këtë rast nyja shquese (ال) shkrihet në shkronjën që vjen pas saj. Shkronjat *shemsijje* janë këto 14:

ت , ث , د , ذ , ر , ز , س , ش , ص , ض , ط , ظ , ل , ن

Idgami shemsijje ndahet më dysh:

1. *Idgami shemsijje mea'l-gunne*: bëhet kur pas nyjës shquese (ال) vjen shkronja *n* (ن) dhe zgjatet 1 *elif mikdari* e gjysmë. P. sh. :

وَ مِنَ النَّاسِ ، وَ النَّجْمِ ، وَ النَّارِعَاتِ

2. *Idgami shemsijje bila gunne*: bëhet kur pas nyjes shquese (ال) vjen ndonjëra prej 13 shkronjave të tjera *shemsijje* dhe gjatë leximit nuk ndahet ndonjë kohë për ta zgjatur atë. P. sh. :

أَلشَّمْسُ ، أَلرَّحْمَانُ ، أَلتَّوْبَةُ

Shkrirja që bëhet te *idgami shemsijje* është *e plotë*. Prandaj, nyja shquese (ال) shkrihet tërësisht në *shkronjën shemsijje* që vjen pas saj dhe ajo shkronjë lexohet sikur të ishte e përforuar me *teshidid*.

Në shembujt më poshtë do të shohim se shkronja *l* (ل) që ndodhet te disa fjalë, nuk është nyjë shquese, por pjesë e vetë fjalës, prandaj edhe në kësi raste nuk bëhet *idgami shemsijje*. P. sh. :

فَالْتَّقِمُ ، إِذِ التَّقَيْتُمْ ، وَالْتَّقَى الْمَاءُ ، وَالْسِنَتُكُمْ

B) *IDH'HARI KAMERIJJE* (الْإِظْهَارُ الْقَمَرِيَّةُ)

Idh'hari kamerije bëhet kur pas nyjës shquese (ال) vjen ndonjëra prej *shkronjave kamerije*. Me këtë rast, nyja shquese (ال) bëhet *idh'har*, pra lexohet qartë pa u shkrirë në shkronjën që vjen pas saj. *Shkronjat kamerije* janë ato që kanë mbetur jashtë *shkronjave shemsijje*. Edhe këto janë 14:

ا ، ب ، ج ، ح ، خ ، ع ، غ ، ف ، ق ، ك ، م ، و ، ه ، ي

Shembuj: الْحَمْدُ ، الْمُؤْمِنُ ، الْقَمَرُ.

Siç do të shohim në shembujt e mëposhtëm, ka disa fjalë te të cilat shkronja *l* (ل) edhe pse lexohet qartë, kësaj nuk i thonë *idh'hari kamerije*, sepse kjo shkronja *l* (ل) është pjesë e rrënjos së asaj fjale. P. sh. :

أَلْهَيْكُمْ ، الْفَيْنِ ، فَالْمُهَمَّهَا ، الْوَانِكُمْ ، الْوَاحِ

SEKTEJA DHE HA-I SEKTEJA

A) SEKTEJA (السّكّة)

Definicioni në texhvid. (السّكّة قطْعُ الصَّوْتِ بِغَيْرِ التَّنْفُسِ).

“Sekte quhet ndërprerja e zërit pa marrë frymë”.

Kohëzgjatja e sektes dallon sipas shpejtësisë së leximit; mesatarisht zgjatet sa 1 elif mikdari.

Sekteja është e veçantë për *lidhjen* e dy fjalëve me njëra-tjetrën. Në qoftë se ndalemi te fjala e parë, pa u lidhur në fjalën vijuese, atëherë nuk bëhet sekte.

Sipas leximit të Asimit, në Kur'anin fisnik ndodhen 4 vende ku bëhet sekteja:

1. Midis ajetit 1 dhe 2 të sures el-Kehf: (عِوْجًا * قَيْمًا).

Këtu më mirë është të ndalemi në fund të ajetit të parë te fjala (عِوْجًا), por është e lejueshme që këtë ta lidhim me fjalën e parë të ajetit të dytë (قَيْمًا). Mirëpo, nëse do t'i lidhim këto fjalë gjatë leximit, atëherë duhet bërë sekte, pra duke e lexuar një herë fjalën e parë (عِوْجًا), por kësaj radhe duke ia hequr *tenvinin* dhe duke e shndërruar atë në *meddi tabi'ij* (عِوْجًا), pastaj e ndërpresim pakëz zërin pa mos marrë frymë dhe kalojmë te fjala vijuese (قَيْمًا).

2. Te ajeti 52 i sures Jasin: (مِنْ مَرْقَدِنَا سَهْدَا).

Edhe këtu është më mirë të ndalemi te fjala (مِنْ مَرْقَدِنَا), sesa ta lidhim atë me fjalën tjeter (هَذَا). Por, në qoftë se i lidhim, atëherë duhet bërë sekte. Kështu që në fillim e lexojmë fjalën (مِنْ مَرْقَدِنَا), pastaj e ndërpresim zërin pa marrë frymë dhe më pastaj kalojmë te fjala (هَذَا).

3. Te ajeti 27 i sures el-Kijameh: (وَ قِيلَ مَنْ سَرَاقٍ).

Këtu më mirë është të bëhet *sekte*, sesa të ndalemi. Prandaj, pasi ta lexojmë fjalën (وَ قِيلَ مَنْ), e ndërpresim zërin pa marrë frymë, presim pakëz dhe kalojmë në fjalën (رَأِقٌ).

4. Te ajeti 14 i surest el-Mutaffifin: (كَلَّا بَلْ سَرَانْ).

Edhe këtu më mirë është të bëhet *sekte*, sesa të ndalemi. Fillimisht e lexojmë fjalën (كَلَّا بَلْ), e ndërpresim zërin dhe pa marrë frymë presim pakëz e pastaj kalojmë në leximin e fjalës (سَرَانْ).

Duke bërë *sekte* në këto katër vende të Kur'anit fisnik, lexuesit dhe dëgjuesit të Kur'anit i jepet mundësia që ta kuptojë më drejtë domethënien e këtyre ajeteve. Përndryshe, sikur në këto vende të mos bënim *sekte*, atëherë te këto fjalë do të vlenin rregulla të tjera, sikur kemi parë më lart, dhe do të lindnin kuptime të reja të tyre.

B) *HA-I SEKTEJA* (هَاءُ السَّكْتِ)

Në Kur'anin fisnik ekzistojnë shtatë fjalë në fund të cilave ndodhet shkronja *h* (ه) e tepërt dhe me *sukun*. Këto *h*-ja quhen *ha-i sekte*. Ato janë:

- | | |
|------------------------------|----------------|
| 1. el-Bekarah, 2 : 259 : | مَوْيَتَسْنَةٌ |
| 2. el-En'am, 6 : 90 : | إِقْتَدِيرٌ |
| 3. el-Haakkah, 69 : 19, 25 : | كِتَابِيَّةٌ |
| 4. el-Haakkah, 69 : 20, 26 : | حِسَابِيَّةٌ |
| 5. el-Haakkah, 69 : 28 : | مَالِيَّةٌ |
| 6. el-Haakkah, 69 : 29 : | سُلْطَانِيَّةٌ |
| 7. el-Kari'ah, 101 : 10 : | مَاهِيَّةٌ . |

Te këto shtatë fjalë bëhet *ha-i sekte*, duke i lexuar ashtu siç janë shkruar dhe pa kurrfarë ndryshimi, daç kur të ndalemi te to, daç kur t'i lidhim këto me fjalët pasuese.

SHQIPTIMI I FJALËS “ALL-LLAH” (لفظة الله)

Mirëfilli dihet se shkronja *l* (ل), në fakt është shkronjë e butë dhe lexohet hollë.

Ndërkaq kur ajo gjendet në emrin „All-llah“ (الله), lexohet në dy mënyra:

1. Nëse shkronja para fjalës „All-llah“ bart vokalin *e* ose *u*, atëherë shkronja *l* e emrit „All-llah“ lexohet trashë, gjegjësisht sikur *ll* e gjuhës shqipe. P. sh. :

(Nasrull-llahi) نَصْرُ اللَّهِ (All-llahu) اللَّهُ

2. Nëse shkronja para fjalës „All-llah“ bart vokalin *i*, atëherë shkronja *l* e emrit „All-llah“ lexohet hollë, gjegjësisht sikur *I* e gjuhës shqipe. P. sh. :

(‘bil-lahi’) بِاللَّهِ (lil-ahi) لِلَّهِ

E njëjtë rregull vlen edhe për fjalën (اللَّهُمَّ). Nëse shkronja para kësaj ka vokalin *e* ose *u*, atëherë shkronja *l* e kësaj fjale do të lexohet *ll*, e nëse ajo ka vokalin *i*, atëherë kjo do të lexohet *l*. P. sh. :

(All-llahumme) اللَّهُمَّ , (ve idh kalull-llahumme) وَإِذْ قَالُوا اللَّهُمَّ
(kulil-lahumme) كُلَّ اللَّهُمَّ

SEXHDE-I TILAVETI (سَجْدَةُ التَّلَاوَةِ)

Sexhde-i tilave quhet sexhdeja e cila duhet bërë pasi të lexohet apo pasi të dëgjohet ajeti në të cilin porositet sexhdeja. Në Kur'an ka 14 vende me ajete të sexhdes. Ato janë:

- | | |
|------------------------|---------------------------|
| 1. el-A'raf, 7 : 206, | 8. en-Neml, 27 : 25, |
| 2. er-Ra'd, 13 : 15, | 9. es-Sexhdeh, 32 : 15, |
| 3. en-Nahl, 16 : 50, | 10. Sad, 38 : 24, |
| 4. el-Isra, 17 : 109, | 11. Fussilet, 41 : 37, |
| 5. Merjem, 19 : 58, | 12. en-Nexhm, 53 : 62, |
| 6. el-Haxhxh, 22 : 18, | 13. el-Inshikak, 84 : 20, |
| 7. el-Furkan, 25 : 60, | 14. el-Alek, 96 : 19. |

Sipas medh'hebit hanefij, personi i cili e lexon apo dëgjon njërin prej këtyre ajeteve të sexhdes, e ka **vaxhib** rënien në sexhde, kurse sipas medh'hebeve të tjera kjo është *sunnet*. Sexhde duhet bërë edhe ai që e lexon apo dëgjon madje edhe përkthimin e këtyre ajeteve. Gjithashtu, sexhde duhet bërë edhe pasi të dëgjohen këto ajete nëpërmjet radios, kasetofonit, televizorit, kompjuterit etj.

Njeriu i cili e lexon ose dëgjon një ajet të sexhdes dhe ndodhet jashtë namazit, ai duhet menjëherë ta bëjë këtë sexhde. Po në qoftë se nuk ka mundësi menjëherë ta kryejë, do ta bëjë më vonë kur t'i jepet rasti.

Në qoftë se ky personi që e lexon ose dëgjon ajetin e sexhdes, është brenda në namaz, atëherë ky nuk duhet të bëjë sexhde të posaçme për ta çuar në vend *sexhden e leximit*, në qoftë se nuk do të lexojë mbas këtij ajeti mbi tre ajete të tjera në vazhdim. Këtij i mjafton sexhdeja e vetë namazit që është duke e falur edhe për sexhden e leximit të ajetit. Mirëpo, nëse dëshiron që mbas ajetit të sexhdes të lexojë më tepër se tre ajete, atëherë ky posa ta lexojë ajetin e sexhdes do të bjerë drejt në sexhde, do ta bëjë sexhden pastaj do të ngrihet në këmbë dhe do të vazhdojë leximin e ajeteve ku kishte mbetur. Personi që del imam, për të mos shkaktuar tollovi me këtë sexhden e leximit, duhet të mundohet që ajetin e sexhdes ta sjellë në fund të leximit të Kur'anit në kijam.

Ta kapërcesh pa e lexuar ajetin e sexhdes vetëm për të mos bërë sexhdeh, është mekruh. Personi që duhet të bëjë sexhde të leximit, duhet t'i plotësojë kushtet e namazxhiut, pra duhet pasur abdest dhe duhet qenë i pastër.

Për sexhden e leximit duhet bërë nijjet. Mirëpo nuk është kusht që te nijjeti të caktohet se sexhden e cilit ajet duhet bërë. Mjafton të thuhet: “*Bëra nijjet që për hir të All-llahut të bëj sexhdei tilaveh*”. Ky nijjet gjatë namazit bëhet vetëm me

mend, me zemër, kurse jashtë namazit mund të bëhet edhe me mend, po më mirë është edhe me gojë.

Si bëhet kjo sexhde?

Njeriu i cili e lexon apo e dëgjon ajetin e sexhdes ngrihet në këmbë, drejtohet kah kibla, e bën nijjetin dhe pa i ngritur duart te veshët thotë "**All-llahu ekber!**" dhe lëshohet në sexhde, ku tri herë thotë: "**Subhane Rabbijel-a'la**". Duke thënë "**All-llahu ekber!**" ngrihet në këmbë dhe e lexon ajetin:

سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا عُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ

(*Semi'na ve eta'na gufraneke Rabbena ve ilejkel-mesir*)

Te sexhdei tilaveti, nuk ka ruku, ulje apo dhënie selam sikurse te namazi.

NDALJA DHE NISJA - VAKF VE IBTIDA

(الْوَقْفُ وَ الْإِبْتِدَاءُ)

A. Definicionet:

Fjala *vakf* nënkupton “ndalje, ndërprerje”, ndërkaq në shkencën e texhvidit nënkupton: “një pauzë gjatë leximit të Kur'anit aq sa të marrësh frysë për të vazhduar me leximin e mëtejmë”.

Ndalja bëhet në fund të fjalës. Në texhvid me rëndësi është që me rastin e ndaljes shkronja e fundit e fjalës merr *sukun* (—).

Fjala *kat'* (الْقَطْعُ) ndërkaq nënkupton ndërprerjen e leximit të Kur'anit për të vazhduar në një kohë tjeter. Kjo ndërprerje bëhet në fund të ajeteve ku përfundon kuptimi i ajitet apo i fjalisë.

Fjala *ibtida'* (الْإِبْتِدَاءُ) do të thotë “nisje”. Ndërsa në shkencën e texhvidit nënkupton “nisjen e leximit të Kur'anit qoftë për herë të parë kur e marrim Kur'anin në dorë, qoftë pasi të kemi bërë pauzë për të marrë frysë gjatë leximit”.

Kjo nisje bëhet me vokal, pra asnjëherë nuk niset me *sukun*, dhe nga një vend i përshtatshëm për nga kuptimi.

B. Rëndësia e kësaj teme:

Çështja e ndaljes dhe e nisjes gjatë leximit të Kur'anit ka rëndësi të veçantë që duhet pasur kujdes sepse nga kjo varet edhe kuptimi i drejtë i ajeteve kur'anore. Të gjithë e dimë se sa e shëmtuar do të dukej në qoftë se lexojmë një poezi a prozë duke mos i respektuar shenjat e pikësimit. E çfarë të thuhet për leximin e Fjalës së All-lahut xh.sh.??!

Nga njohuritë që na përcjellin Ummu Seleme dhe Enes bin Malik shohim se çfarë rëndësie i ka dhënë ai vetë kësaj çështjeje. Ummu Seleme, bashkëshortja e Muhammedit a.s. përcjell se: “Pejgamberi a.s. e lexonte Kur'anin duke bërë ndërprerje”⁴. Sipas kësaj nënkuptohet që Pejgamberi a.s. i ka respektuar shenjat e pikësimit gjatë leximit të Kur'anit.

Jo vetëm imamët e leximit të Kur'anit por edhe shkencëtarë të tjerë islamë janë marrë me këtë temë dhe kanë shkruar vepra të tëra vetëm për këtë çështje, si Ibnul Enbari, Ebu Amr Dani, Sexhavendi etj.

⁴ Tirmidhiu, *Fedailu'l-Kur'an*; Ebu Davudi, *Vitr.*

C. Rregullat e ndaljes:

Gjatë leximit të Kur'anit duhet t'i kemi parasysh këto rregulla nëse bëjmë ndalje:

1. Te vokali "e": Në qoftë se shkronja e fundit e fjalës në të cilën duam të ndalemi bart vokalin "e" (fet'ha), atëherë me rastin e ndaljes kjo "e" shndërrohet në *sukun* (ْ) të përkohshëm. P. sh.:

الْعَالَمِينَ ← الْعَالَمِينَ

2. Te vokali "i": Në qoftë se shkronja e fundit e fjalës në të cilën duam të ndalemi bart vokalin "i", atëherë kjo mund të lexohet në dy mënyra:

a. Me *sukun*: الْرَّحِيمُ ← الْرَّحِيمُ

b. Me *reum**: الْدِّينُ

3. Te vokali "u": Në qoftë se shkronja e fundit e fjalës në të cilën duam të ndalemi bart vokalin "u", atëherë kjo lexohet në tri mënyra:

a. Me *sukun*: الْحَكِيمُ ← الْحَكِيمُ

b. Me *reum*: الْعَلِيمُ

c. Me *ishmam**: نَسْتَعِينُ

Në qoftë se shkronja e fundit e fjalës në të cilën duam të ndalemi bart *teshidid*, atëherë edhe në këtë rast ndalemi me *sukun*. Mirëpo, për të dhënë shenjë se shkronja e fundit bart *teshidid*, atë *sukun* duhet zgjatur pakëz. P.sh. (الْشُّخْ).

Ndërkaq nëse shkronja e fundit që bart *teshidid* është "m" ose "n", atëherë kjo zgjatje bëhet pak më tepër sesa në rastet tjera. P.sh. هُنْ ، هُلُمْ

Te ndalimi i këtyre shkronjave me *teshidid* nuk shqiptohet në asnjë formë vokali që ato bartin.

Le të përkujtojmë këtu që në qoftë se para shkronjës te e cila duam të ndalemi ka një shkronjë *meddi* (zgjatjeje) ose shkronjë *lini*, këto do të shndërrohen në *meddi arid* ose *meddi lin*. Më tepër për këto zgjatje shiko faqet 29-32.

* Shiko fusnotën nr. 2, faqe 30.

* Shiko fusnotën nr. 3, faqe 30.

4. Te *sukuni*: Në qoftë se shkronja e fundit në të cilën duam të ndalemi bart *sukun* ose nuk bart asnijëfarë vokali a shenje, atëherë ajo lexohet ashtu siç është. P.sh. ﴿أَمْنُوا﴾ ، قُلْ .

5. Te *tenvini*: Në qoftë se shkronja e fundit te e cila duam të ndalemi bart *tenvin*, atëherë vleinë këto rregulla:

a. Në qoftë se bart *tenvinin* “in” (ـ) ose “un” (ـ), atëherë *tenvini* nuk lexohet, dhe në vend të tij shkronja e fundit lexohet me *sukun*. P.sh.:

مَاكُولٌ ← مَاكُولٌ ، سَائِلٌ ← سَائِلٌ

b. Në qoftë se bart *tenvinin* “en” (ـ)، atëherë ky *tenvin* shndërrohet në *elis* dhe ndalja bëhet sikur të kishim pasur këtu *meddi tabii*. P.sh.:

تَوَّابًا ← مَاءً ، مَاءً ← مَاءً

Në qoftë se *tenvini* “en” vjen mbi shkronjën “t” të rrumbullakët (ة ة)، kur të ndalemi te fjala që në fund ka këtë shkronjë, atëherë bie *tenvini* dhe kjo shndërrohet në “h” (ه ه). P.sh.: رَحْمَةً ← رَحْمَةً.

6. Te shkronja “v” dhe “j”: Në qoftë se në fund të fjalës te e cila duam të ndalemi kemi shkronjën “v” dhe shkronja para saj bart vokalin “u”; ose kemi shkronjën “j” dhe shkronja para saj bart vokalin “i”, që sipas rregullit këto quhen *harfi medd* (shkronjë e zgjatjes), atëherë këtu ndalemi duke i lexuar me *meddi tabii*. P. sh.:

إِلَّا هُوَ ← إِلَّا هُوَ ، مَا هِيَ ← مَا هِيَ

Në qoftë se në fund të fjalës ka *elis*, sërisht edhe këtu ndalemi duke lexuar me *meddi tabii*. P.sh.: أَرْسَلْنَا .

Në qoftë se shkronja “v” ose “j” në fund të fjalës ku duam të ndalemi nuk bëhen shkronja të *meddit*, atëherë ato lexohen normalisht me *sukun* si çdo shkronjë tjeter. P.sh.:

خَلْوَ ، هَدَى ← هَدْيٌ ، هَدَى ← هَدْيٌ

7. Te përemri pronor i vetës së tretë në gjininë mashkullore (ه ه): Nëse shkronja e fjalës së fundit tek e cila duam të ndalemi është “h” (ه ه), atëherë këtu ndalemi duke e lexuar atë me *sukun*. P.sh.:

عَنْهُ ← رَبَّهُ ، رَبَّهُ ← عَنْهُ

8. Fjalët në vijim që kanë disa specifika të dalluara, po i paraqesim me disa rregulla që vlejnë për to:
- Përemri vëtor i vetës së parë në njëjës ﴿أَنَا﴾ : Sipas të gjitha leximeve, në rast ndaljeje te ky përemër, ai shndërrohet në meddi-tabii dhe ndalemi në të duke e zgjatur sa një meddi tabii (“enaa”). Në rast vazhdimi, ai lexohet shkurt (“ene”).
 - Fjala لِكَنَّا (Kehf 18:36): Në rast të ndaljes – me konsensus – lexohet duke e zgjatur. Në rast të vazhdimit të leximit, sipas disa imamëve, ndër ta edhe sipas transmetimit të Hafsit, nuk zgjatet (“Laakinne”), kurse sipas disa të tjerëve zgjatet (“laakinnaa”).
 - Fjala الظُّنُونَ (Ahzab 33:10): Sipas imam Asimit, në rast të ndaljes zgjatet (“edh-dhanuunaa”), kurse në rast të vazhdimit ajo lexohet shkurt (“edh-dhanuune”).
 - Fjala الْرَّسُولُ (Ahzab 33:66): për këtë vlen rregulli i mësipërm nën c.
 - Fjala الْمَسِيَّلُ (Ahzab 33:67): për këtë vlen rregulli i mësipërm nën c.
 - Fjala سَلَاسِلًا (Insan 76:4): Kjo fjalë është lexuar ndryshe-ndryshe. Sipas imam Asimit, transmetimi i Hafsit, kjo lexohet në dy mënyra në rast të ndaljes te ajo: duke e zgjatur (“selaasilaa”) ose duke e lexuar shkronjën e fundit “I” me *sukun* (“selaasil”). Ndërkaq në rast të vazhdimit të leximit ajo lexohet shkurt (“selaasile”).
 - Fjala (Insan 76:15): Sipas transmetimit të Hafsit kjo fjalë lexohet gjatë nëse ndalemi tek ajo (“kavaariira”) dhe shkurt nëse vazhdojmë leximin më tej (“kavaariira”).

D. Pjesët e ndaljes (*vakfit*):

Varësisht nga vendi ku bëhet ndalja (*vakfi*), ajo ndahet në katër pjesë:

- Ndalja e plotë** (الْوَقْفُ التَّامُ): Ndalje e plotë quhet ajo që nuk ka as lidhje kuptimi as lidhje teksti me fjalën që vjen pas saj. Me fjalë të tjera, e këtillë quhet ndalja që është e plotë nga të gjitha aspektet. P.sh. e plotë është ndalja në fund të ajitet të pestë të sures el-Bekara:

وَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ...

Këtu përfundon edhe teksti (ajeti) por edhe kuptimi i ajeteve paraprake. Pas kësaj fillojnë ajetet me një tematikë tjeter.

Ndalje të plotë zakonisht kemi në fund të ajeteve, në fund të rrëfimeve si dhe në fund të çdo sureje.

2. Ndalja e mjaftueshme (الْكَافِيٌّ): quhet ndalja e cila bëhet aty ku fjala, si për nga teksti ashtu edhe për nga kuptimi, është e plotë, por që vazhdon më tej lidhshmëria kuptimore e saj. P.sh. e këtillë është ndalja që bëhet në fund të ajetit të gjashtë i sures el-Bekara:

... أَمْ مَمْ تُنذِرُهُمْ لَا يُؤْمِنُونَ.

Në këtë ajet teksti është i plotë, mirëpo kuptimi i tij vazhdon edhe në ajetin vijues. Sepse All-llahu xh.sh. vazhdon fjalën e Tij për mosbesimtarët edhe në ajetin vijues.

3. Ndalja e mirë (الْوَقْفُ الْخَيْرُ): quhet ndalja e cila bëhet aty ku kuptimi është i plotë mirëpo që vazhdon lidhshmëria e tekstit edhe më tej. P.sh. e këtillë është ndalja e cila bëhet pasi ta kemi lexuar vetëm këtë pjesë nga sureja Fatiha:

الْحَمْدُ لِلَّهِ

Fjala te e cila jemi ndalë në fakt në vete ka kuptim, mirëpo teksti i ajetit vazhdon edhe më tej dhe ajo fjalë është e lidhur si për nga teksti ashtu edhe për nga kuptimi me pjesën tjeter të ajetit.

4. Ndalja e shëmtuar (): është ndalja që bëhet në fjalën e cila, si për nga teksti ashtu edhe për nga kuptimi, është e lidhur me pjesën që vjen pas saj. Ndalja në këtë vend shkakton kuptimin jo të drejtë të tekstit. P.sh. te sureja Fatiha të ndalemi te fjala: الْحَمْدُ لِلَّهِ . Nëse ndalemi këtu, atëherë vetëm kjo nuk na jep ndonjë kuptim. Po kështu, edhe sikur të sqarojë diçka por që nuk e jep kuptimin që ka për qëllim teksti, edhe kjo është një ndalje e shëmtuar. P.sh. te ajeti 43 i sures en-Nisa', nëse e lexojmë vetëm tekstin në vijim dhe ndalemi:

لَا تَقْرِبُوا الصَّلَاةَ

Që për nga kuptimi i vjen: "Mos iu afrohuni namazit!", ndërkokë që kuptimi më i plotë i këtij teksti është: "O ju që besuat, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur...".

Në qoftë se për arsyet e ndryshme, kryesisht për shkak të mbarimit të fryshtëmarrjes, detyrohemit të ndalojmë si te rastet nën pikën 3 dhe 4, atëherë leximin duhet ta nisim nga një vend paraprak më të përshtatshëm që i jep kuptim të mirë leximit.

E. Shenjet e ndaljes/pikësimit (*sexhavendet*):

Përcaktimi i ndaljeve të përmendura më sipër nuk është e kollajshme për të gjithë, sidomos për ata që nuk e njohin gjuhën arabe. Duke e marrë parasysh këtë fakt, është ndjerë nevoja që të vihen disa shenja pikësimi. Këtë për herë të parë e ka bërë Muhammed b. Tajfur es-Sexhavendi (v. 560/1165)* duke i vendosur shenjet: م ط ز ص , të cilave më poshtë do t'ua japim kuptimin. Më vonë janë shtuar edhe disa shkronja të tjera dhe të gjitha këto kanë gjetur mirëkuptim dhe janë zgjeruar në mesin e muslimanëve.

Tani, t'i shohim këto shenja dhe vlerat e tyre:

(ر): *el-vakfu'l-lazim*, që nënkupton ndaljen e domosdoshme. Është shenjë se nëse vazhdojmë dhe nuk ndalemi do t'ia prishim kuptimin tekstit. Në Kur'an kjo shenjë ndodhet në 84 vende.

(ط): *el-vakfu'l-mutlak*, është një shenjë që ndodhet aty ku teksti merr kuptim të plotë. Këtu është më mirë të ndalemi sesa të vazhdojmë leximin, edhe pse lejohet vazhdimi i tij.

(ج): *el-vakfu'l-xhaiz*, te kjo shenjë preferohet ndalja, edhe pse lejohet edhe vazhdimi i leximit.

(ق): *Kif*, që nënkupton "Stop!, Ndal!". Edhe këtu më mirë është ndalja sesa vazhdimi.

(ج): *el-vakfu'l-muxhevvez li vexh'hih*, te kjo shenjë më mirë është të vazhdohet leximi sesa të ndalemi, edhe pse lejohet edhe ndalja. Nëse ndalemi te kjo shenjë, atëherë nuk ka nevojë ta nisim leximin nga një vend i mëparshëm, por vazhdojmë nga vendi ku jemi ndalur.

* Muhammed bin Tajfur es-Sexhavendij el-Gaznevijj, *Kitabu'l-vakf ve'l-ibtida'*, 2001, Amman.

(ص): *el-vakfu'l-murahhas daruraten*, kjo shenjë ndodhet në vende ku mund të ndalemi për arsyе ngushtimi. Këtu më mirë është të vazhdojmë leximin sesa të ndalemi. Nëse ndalemi te kjo shenjë, atëherë nuk ka nevojë ta nisim leximin nga një vend i mëparshëm, por vazhdojmë nga vendi ku jemi ndalur.

(ق): Këtu vazhdimi i leximit është më mirë sesa ndalja. Nëse ndalemi këtu, nuk e rinisim leximin te ndonjë vend paraprak.

(ل): *ma la vakfe alejh*, që nënkupton "mos u ndal!". Nëse na soset fryma dhe detyrohemë të ndalemi këtu, atëherë rinisjen e leximit duhet ta bëjmë te ndonjë vend më i përshtatshëm paraprak. Në qoftë se kjo shenjë ndodhet në fund të ajetit, kjo nënkupton se ka lidhshmëri kuqtimore të këtyre dy ajeteve. Në këto fundajete mund edhe të ndalemi por edhe të vazhdojmë leximin. Nëse ndalemi, nuk duhet ta rinisim leximin nga ndonjë vend paraprak.

(ـ ـ): dy grupe të tri pikave. Këto dy grupe shenjash zakonisht vijnë në të njëjtin ajet por në fjalë të ndryshme, njëri pas tjetrit. Në këtë rast ne duhet të ndalemi te njëri grup i tri pikave. Nuk guxojmë të ndalemi te të dyja grupet e pikave por as edhe t'i kalojmë të dyja pa u ndalur te njëra prej tyre.

(صلی): *sili*, është shenjë se ndalja është e lejuar, mirëpo preferohet vazhdimi i leximit.

(ق): është shenjë pikësimi që nënkupton se këtu më mirë është ndalja sesa vazhdimi, megjithëse edhe vazhdimi është i mundshëm.

(ك): nënkupton "po ashtu" (كذلک). Pra, kjo shenjë tregon se këtu vlen e njëjtë shenjë pikësimi sikurse e mëparshmjë.

(ع): është shenjë e *ruqkusë*. Kjo tregon se këtu përfundon një temë a një rrëfim dhe nga këtu nis një temë a rrëfim tjetër. Për ata që falin namaz me hatme ose që lexojnë gjatë Kur'an në namaz, nënkupton se këtu është e përshtatshme të përfundohet leximi dhe të shkohet në *ruku'*. Po ashtu, edhe ata që lexojnë ashëre nga Kur'ani, është mirë që të lexojnë nga njëri "ajn" (ع) deri te tjetri, për ta ruajtur tërësinë e temës apo të rrëfimit.

(خ): është shkurtesë për (حُمْسَةٌ), që nënkupton “pesë”. Në disa mus’hafë vihet pas çdo të pestit ajet. Pra është një ndarje pesëshe e ajeteve.

(مد): është shenjë e zgjatjes, *meddit* (مَدْ). Shkronja e cila e ka nën vete këtë shenjë nënkuptohen se duhet të zgjatet sa një *medd'i-tabii*.

(قصر): është shenjë e shkurtimit, *kasr* (قَصْرٌ). Shkronja që e ka nën vete këtë shenjë nënkupton se duhet të lexohet shkurt, pa e zgjatur.

(س): Kur kjo shkronjë të vijë mbi ndonjë fjalë, nënkupton se aty ka “sekteh”.

(سكتة): është shenjë për *sekten* (الْسَّكْتَةُ). Për *sekten* shiko f. 41-42.

(س): Kur kjo shkronjë të vijë nën shkronjën “sad” (ص), kjo nënkupton se shkronja “sad” duhet të lexohet si “sin” (س).

(امالة): Fjala nën të cilën gjendet kjo shenjë, nënkupton se këtu duhet të bëhet “imaleh” (إِمَالَةٌ). Më tepër për “imalen”, shiko fusnotën në f. 12.

(تسهيل): do të thotë “lehtësim”. Nëse vijnë dy “hemze” pas njëra-tjetërës, atëherë hemzeja e dytë lexohet më e butë, duke mos e theksuar në mënyrë të veçantë. P.sh. ءَاعْجَمِيٌّ .

(﴿): kjo shenjë tregon se në fund të këtij ajeti duhet bërë *sexhde-i tilaveh*. Më tepër për *sexhde-i tilaven* shiko f. 44-45.

Në disa mus’hafë të rinj ndodhen edhe shenja të tjera përveç këtyre që i përmendëm këtu. Për kuptimin e atyre shkronjave kryesisht jepen sqarime në fund të mus’hafëve.

GABIMET GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT FISNIK

Për gabimet gjatë leximit të Kur'anit përdoret shprehja arabe *lahnun* (لَهْنُ), që nënkupton ‘gabimin e shkaktuar nga mosrespektimi i rregullave të *texhvidit*’.

Lahni (gabimi në të lexuar) ndahet në dy pjesë:

1. Lahni xhelij (الْحُنُّ الْجَلِّيُّ): quhet gabimi i hapur që bëhet, me rastin e leximit, në vetitë e domosdoshme të shkronjave. Meqë këto janë gabime që i heton çdokush, quhen *gabime të hapura*.

Ky lloj i gabimit kryesisht bëhet në tri vende:

a) *Te shkronjat*: ky lloj i gabimit bëhet duke e zëvendësuar një shkronjë me një tjetër (p. sh. fjalën صِرَاطٌ ta lexojmë), duke shtuar një shkronjë tepër (p. sh. duke e bërë *kalkalen* gabimisht t'i vëmë *teshidid* ose t'i shtojmë një *hemze -ء*), ose duke fshehur e mangësuar një shkronjë (p. sh. të mos e shqiptojmë *meddin tab'iij*).

b) *Te vokali (zanorja)*: janë gabimet që bëhen duke e ndërruar vokalin e një shkronje ose duke e bërë me *sukun* një shkronjë të pavokalizuar (p. sh. fjalën أَلْحَمْدُ لِلَّهِ ta lexojmë).

c) *Te sukuni*: është gabimi që bëhet kur një shkronje me *sukun* i vëndojojmë vokal (p.sh. fjalën لَمْ يَلِدْ ta lexojmë).

Gabimet që bëhen në këto tri mënyra, pavarësisht ia ndërrojnë kuptimin ose jo fjalës, quhen *gabime të hapura* dhe meqë një musliman e ka *farzi ajn* (obligim individual) praktikimin e *texhvidit* aq sa do t'u ikte gabimeve të hapura, nënkuptohet se ky musliman e lë një farz, kryen një **haram**, duke mos u ikur këtyre gabimeve të rënda gjatë leximit të Kur'anit fisnik.

2. Lahni hafiji (الْحُنُّ الْخَفِيُّ): quhet gabimi i fshehur që bëhet në vetitë jo të përhershme të shkronjave. Meqë këto gabime nuk mund t'i hetojë çdokush, përpos njerëzve që i njohin rregullat e *texhvidit*, quhen *gabime të fshehura*.

Ky lloj i gabimeve shqyrtohet në dy raste:

- a) Gabimet që mund t'i vërejë çdokush që ka pak a shumë njoħuri lidhur me *texhvidin*. P. sh. lēnia e *ihfasē*, *iklabit*, *idh'harit*; moszgjatja e duhur e *meddeve vaxhib*; zgjatja e tepërt e *meddit tabi'ij* etj.
- b) Gabimet që mund t'i vërejë njeriu i cili ka njoħuri tē thella nē shkencēn e *texhvidit*. Pēr shembull, gabimet që bēhen te vetia e *tekririt* (pērsēritjes, dridhjes) e shkronjēs *r* (ر); te vetia e *gunnes* te shkronjat *n* (ن) dhe *m* (م), duke kaluar nē skajshméri gjatë shqiptimit tē tyre.

Gabimet që hyjnë nē pjesën e parë tē *lahni hafijjit*, janē **mekruhi tahrimen**. Prandaj, ruajtja e leximit tē Kur'anit prej këtyre gabimeve éshtë *vaxhib*. Kurse gabimet që hyjnë nē pjesën e dytë tē *lahni hafijjit*, janē **mekruhi tenzihen**. Prandaj, ruajtja e leximit tē Kur'anit prej këtyre gabimeve éshtë mustehab.

Pēr sa i pērket asaj se a e prishin namazin kēto lloje gabimesh, janē dhēnē mendime tē ndryshme. Pērgjithësisht: Gabimet që bēhen me rastin e leximit, nē qoftë se ua prishin ose ua paqartēsojnē kuptimin ajeteve kur'anore, atēherë ai namaz me gabime tē këtilla éshtë i pavlefshëm. Po nē qoftë se nuk u prishet kuptimi e as nuk u paqartēsohet, atēherë me kēto gabime kemi bërë *mekruh tahrimen* ose *tenzihen*, varësisht sipas shkallës sē gabimit.

SJELLJET GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT

Lidhur me sjelljen që duhet të shfaqë lexuesi i Kur'anit ka një sërë ajetesh kur'anore, hadithe si dhe fjalë të dijetarëve të mëdhenj. Është kërkesë e besimit dhe e sinqueritetit tonë që kur të lexojmë Kur'an të sillemi në mënyrë të denjë, ashtu siç e meriton Fjala e Krijuesit tonë, All-llahut xh.sh. Në këtë drejtim po përmendim disa pika:

1. Para se ta marrim Kur'anin në dorë për ta lexuar, pikë së pari duhet të marrim abdest. Nuk lejohet prekja e Kur'anit pa abdest. Mirëpo lejohet leximi i Kur'anit pa abdest, duke mos e prekur atë dhe duke mos e marrë në dorë. Po ashtu, edhe personi i cili lexon përmendsh pjesë nga Kur'ani, nuk është e obligueshme të ketë abdest, mirëpo më e pëlqyeshme është që edhe me këtë rast të ketë abdest. Personat që janë *xhunub* ose gratë me menstruacione nuk lejohet të këndoijnë pjesë nga Kur'ani as me mus'haf të hapur e as përmendsh. Mirëpo ata kanë të drejtë ta dëgjojnë këndimin e Kur'anit që interpretohet nga dikush tjetër. Personat *xhunubë* ose gratë me menstruacion nëse nuk mund të gjejnë ujë për të marrë gusël, ose nuk kanë ujë të ngrohtë për të, lejohet që ata të marrin tejemmum dhe të vazhdojnë të kryejnë ibadetet dhe të lexojnë Kur'an.
2. Është *mustehab* (e pëlqyeshme) që personi i cili lexon Kur'an të jetë i ulur në një vend të pastër. Nuk lejohet dhe nuk i ka hije Fjalës së Zotit, që ai të lexohet në tualet, banjë apo edhe në ndonjë vend tjetër të pistë. Po ashtu, ai që lexon Kur'an, edhe teshat duhet t'i ketë të pastra.
3. Ai që lexon Kur'an, është mirë që mundësish të kthehet kah Kibla, Qabeja. Është mirë që Kur'anin ta lexojë duke qenë i ulur në gjunjë dhe duke e bartur në dorë ose në rahle, bankë, dhe të mos e lëshojë atë nën bel. Krejt kjo si respekt ndaj Fjalës së All-llahut xh.sh.
4. Kur'ani të lexohet me *tertil*, pjesë-pjesë, dhe sipas rregullave të *texhvidit*.
5. Kur'ani të lexohet me zë të bukur, por pa e tepruar dhe pa i shkelur rregullat e texhvidit. Nëse nuk e pengojmë dikë dhe nëse nuk bëhet shkak për lavdëresë, më mirë është që Kur'anin ta lexojmë me zë sesa pa zë.
6. Gjatë leximit të Kur'anit është më sevap, më e lavdërueshme te Zoti, që të shikojmë në mus'haf edhe gjatë leximit të pjesëve që mund t'i dimë përmendsh.
7. Gjatë leximit të Kur'anit të fokusohemi me mend e me shpirt në të, duke e ditur se jemi duke e lexuar Fjalën e All-llahut xh.sh. dhe se në një farë forme jemi duke biseduar me Krijuesin tonë.
8. Synimi ynë kryesor duhet të jetë që atë që e lexojmë nga Kur'ani të përpinqemi edhe ta kuptojmë. Këtë mund ta bëjmë duke përdorur Kur'ana që janë në dy gjuhë: arabisht dhe shqip ose në ndonjë gjuhë tjetër. Sot për

këtë ekzistojnë dhe mjaft aplikacione për telefona celularë si dhe faqe interneti, p.sh. www.tanzil.net.

All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë: "(Ky është) *Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.*" (Sad 38:29).

9. Akoma më e rëndësishme se leximi dhe kuptimi i Kur'anit është vënia e tij në praktikë, të jetuarit me Kur'an. Nëse nuk e bëjmë këtë, në qoftë se Kur'ani nuk është udhërrëfyesi dhe drita e jetës sonë, çfarë do bie të ngelë nga leximi dhe kuptimi i Kur'anit.

Indeksi i termeve

D

Damiri · 20

H

Ha-i sekte · 42

I

Ibtida · 46

Idgam · 8, 10, 11, 14, 33, 35

Idgam bila gunneh · 10, 35

Idgam mea'l-gunneh · 10, 35

Idgami i plotë · 34

Idgami jo i plotë · 34

Idgami mithlejn · 36

Idgami mutekaribejn · 38

Idgami mutexhanisejn · 37

Idgami shemsijje · 39

Idh'har · 8, 9, 14

Idh'hari kamerijke · 40

Ihfa · 8, 13, 14

Iklabi · 12

Ishmami · 30

K

Kalkale · 18

Kasr · 30, 32

L

Lahni hafijj · 54

Lahni xhelij · 54

Lamut-ta'rifi · 39

M

Meddi · 22, 24, 25, 26, 27, 29, 31

Meddi aridi · 29

Meddi lazim · 27, 28

Meddi liini · 31

Meddi munfasil · 26

Meddi muttasil · 25

Meddi tabi'ij · 24

N

Nuni Sakin · 8

R

Revmi · 30

S

Sekteja · 41

Sexhavendet · 51

Sexhde-i tilave · 44

Shkaqet e meddit · 22

Shkronjat e meddit · 22

T

Tenvini · 8

Tevassut · 30, 31, 32

Texhvid · 3, 7, 10, 18, 30, 41, 46

Tuul · 30, 31, 32

V

Vakf · 46